

RAPORTI VJETOR 2011

PËRMBAJTJA

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm	04
Mesazh nga Këshilli Drejtues	08
Këshilli Drejtues	10
Struktura Organizative	12
Segmentet tona të biznesit	14
Përgjegjësia Sociale e Korporatës	26
Treguesit kryesorë financiar 2011	28
Objektivat për vitin 2012	30
Adresat	32
Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditit (mbyllur më 31 dhjetor 2011)	35

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm

“Ne synojmë të jemi ndër bankat kryesore në ofrimin e shërbimeve financiare për sektorin e biznesit në Shqipëri, duke mbuluar njëherazi të gjitha nevojat e klientëve, ndërkohë që sigurojmë të ardhura të qëndrueshme për aksionerët tanë, për të përfituar nga mbështetja e tyre aktive për zhvillimin e mëtejshëm dhe rritjen e pjesës tonë të tregut. Ofrimi i punësimit të sigurt për të gjithë punonjësit tanë, është sigurisht pjesë e qenësishme e këtij qëllimi”



Në fund të vitit 2011, banka u pozicionua si një ndër pesë bankat më të mëdha në Shqipëri dhe e dyta për sa i përket përfitueshmërisë për Kthimin mbi Aktivitet (RoA) dhe Kthimin mbi Kapitalin Aksioner (RoE).



Ne ndihmojmë kompanitë me transaksionet e tyre, menaxhimin e Cash-it, si dhe riskut të monedhës e luhatjeve të interesit. Ne jemi të impenjuar të lehtësojmë marrëdhëniet ekonomike dhe të krijojmë vlerë për klientët tanë.

Të nderuar lexues,



Artan Santo, Drejtor i Përgjithshëm

Ndonëse shumica e drejtuesve të bankave e kujtojnë vitin 2010 si një vit me intensitet shumë të lartë, viti 2011 e rriti më tej intensitetin. Gjatë këtij viti ne riorganizuam proceset kryesore, rritëm kapitalin dhe likuiditetin, por, edhe më e rëndësishme, rritëm kapacitetet udhëheqëse në treg për t'u shërbyer më mirë nevojave të klientëve për shërbime financiare. Ecurinë e dukshme gjatë vitit 2011 e tregojnë më mirë rezultatet tona financiare. Banka arriti një fitim neto prej 1.6 miliardë Lek (një rritje prej 150% nga viti 2010), të ardhura neto nga interesat prej 4.1 miliardë Lek (një rritje prej 51% krahasuar me vitin 2010). Në fund të vitit 2011 banka u pozicionua si një ndër pesë bankat më të mëdha në Shqipëri dhe e dyta për sa i përket përfitueshmërisë për Kthimin mbi Aktivitet (RoA) dhe Kthimin mbi Kapitalin Aksioner (RoE). Portofoli i depozitave arriti rekordin prej 71 miliardë Lek në fund të vitit, që tregon se klientët vazhdojnë ta shohin bankën tonë si një partner të besueshëm dhe të qëndrueshëm.

Gjatë vitit 2011 puna jonë u përqëndrua në dy synime kryesore: së pari, tërheqja e klientëve të rinj, zgjerimi i rrjetit dhe rritja e mbështetjes për ekonominë shqiptare; dhe së dyti, forcimi i pasqyrës financiare dhe pozicionimit të kapitalit me qëllim krijimin e kushteve për një rritje afatgjatë të vlerës për aksionerët. Kjo punë është në vazhdim dhe ne jemi duke bërë progres të dukshëm. Rishtazi kemi nxjerrë edhe vizionin dhe strategjinë tonë të re. “Ne synojmë të jemi ndër bankat kryesore në ofrimin e shërbimeve financiare për sektorin e biznesit në Shqipëri, duke mbuluar njëherazi të gjitha nevojat e klientëve, ndërkohë që sigurojmë të ardhura të qëndrueshme për aksionerët tanë, për të përfituar nga mbështetja e tyre aktive për zhvillimin e mëtejshëm dhe rritjen e pjesës tonë të tregut. Ofrimi i punësimit të sigurt për të gjithë punonjësit tanë, është sigurisht pjesë e qenësishme e këtij qëllimi”. Me këtë synim, ne kemi përcaktuar katër parime biznesi që do të udhëheqin aktivitetet dhe do të përqëndrojnë burimet tona:

Kompani e orientuar drejt klientit



Të qenit koherent ndaj nevojave të klientëve duke u siguruar atyre produktet dhe shërbimet që kanë nevojë, në kohën dhe vendin që ata kanë nevojë për to, është pjesë e domosdoshme për suksesin e punës tonë. Ndaj ne po marrim vendime biznesi duke dëgjuar klientët tanë dhe duke i'u përgjigjur nevojave dhe preferencave të tyre. Për ta realizuar këtë gjë me më shumë efikasitet, gjatë vitit 2011, kompania jonë kreu një riorganizim të rëndësishëm nëpërmjet krijimit të katër divizioneve. Synimi i këtij riorganizimi ishte pozicionimi i njësive tona operacionale për t'u shërbyer më mirë klientëve tanë. Credins bank i shërben tre grupimeve kryesore të klientëve dhe konkretisht individëve, bizneseve dhe institucioneve publike. Për këto grupime ne kemi ndërmarrë hapa të rëndësishëm për secilin në veçanti. Klientët individë dëshmojnë se janë besnik ndaj nesh dhe ne e dimë arsyen pse: sepse jemi banka që i trajton ata mirë dhe u ofron vlerë të shtuar në terma afatgjatë edhe nëse në momentin e parë mund të mos jetë kryer marrëveshja optimale, ata ndjejnë se pritshmëritë e tyre janë duke u plotësuar ndaj dhe do vazhdojnë të na zgjedhin ne pa asnjë hezitim për çdo transaksion të ri që bëjnë. Gjatë vitit 2011 u morën edhe hapa të tjerë të rëndësishëm, rrjeti ynë u zgjerua më tej, si dhe u bënë përmirësime të rëndësishme për sa i përket shërbimeve dhe produkteve tona. Tregtimi i arit, depozita kalendarike, paketat e



Katër parime biznesi:

- Kompani e orientuar drejt klientit
- Rezultate pozitive për aksionerët tanë

- Fleksibilitet dhe përshtatje në aktivitetin bankar vendas
- Krijim i një kulture mbizotëruese gjithpërfshirëse



veçanta për bizneset dhe klientët individë, shërbimet e personalizuara të FOREX-it, janë të gjitha dëshmi të përmirësimeve të bëra drejt vizionit tonë afatgjatë për të qenë udhëheqës në ofrimin e shërbimeve financiare me cilësi të lartë. Gjithashtu, në vijim të këtij parimi si pjesë e projekteve afatgjata, nga fundi i muajit shtator 2012, ne synojmë të nxjerrim një zgjidhje të re e-banking. Kjo platformë e re elektronike do të shërbejë për një përjasje të një tregu më të gjerë si dhe për t'u ofruar klientëve tanë lehtësirat më të fundit në sistemin bankar të mobile banking dhe e-banking, me çmime konkurruese.

Kur u shërben bizneseve të të gjitha madhësive, ideja mbetet e njëjtë: ne ju ofrojmë zgjidhje të qarta dhe të thjeshta duke maksimizuar kështu vlerën afatgjatë dhe garantuar kënaqësinë e tyre. Po ti referohemi rrjetit tonë të degëve dhe klientelës, në mënyrë direkte dhe jo-direkte, Credins bank brenda kuadrit të biznesit të saj, po realizon një funksion të rëndësishëm ekonomik, për të cilin ne jemi krenar. Ne ndihmojmë kompanitë me transaksionet e tyre, me menaxhimin e Cash-it, si dhe riskut të monedhës e luhatjeve të interesit. Ne dëshirojmë të lehtësojmë marrëdhëniet ekonomike dhe të krijojmë vlerë për klientët tanë. Përveç këtyre dhe përmirësimit të strukturës organizative, si dhe përmendëm më sipër, ne jemi në fazën e parë të një projekti interesant; krijimin e Njesisë për Menaxhimin e Marrëdhënies me Klientin, e cila do të përqendrojë fokusin tonë ndaj nevojave dhe kënaqësisë së klientit.

Ndër historitë tona të suksesit janë padyshim edhe marrëdhëniet me institucionet publike, të cilat janë forcuar nga viti në vit. Menaxhimi i kujdesshëm i fondeve të buxhetit, ofrimi i paketave interesante për pagat e punonjësve të administratës si dhe lehtësimi i transaksioneve financiare për këto institucione, janë të gjitha pjesë e shërbimeve tradicionale që ofrohen nga banka jonë. Këto e bëjnë bankën tonë një nga zgjedhjet e preferuara për institucionet publike.

Këto përpjekje po japin rezultatin e tyre. Klientët vazhdimisht na thonë se sa shumë ne mund të bëjmë për tu krahasuar me konkurentët tanë, si rrjedhojë, gjithmonë e më shumë ata po e risin besimin e tyre ndaj nesh. Duke na dhënë mundësinë për t'u shërbyer, klientët tanë kanë rritur referimet në adresë të bankës dhe kjo reflektohet çdo ditë me prurje të qëndrueshme në të gjithë rrjetin tonë.

Rezultate pozitive për aksionerët tanë

Rezultatet për aksionerët tanë fillojnë me një bilanc financiar solid, i cili është thelbësor në menaxhimin e çdo biznesi. Rezervat e mjaftueshme, raporti i mirë i kapitalit dhe aktivet e qëndrueshme na lejojnë t'i bëjmë ballë situatave të vështira dhe në të njëjtën kohë na japin fleksibilitetin për ta përdorur kapitalin tonë sipas nevojës – si për shëmbull për të rritur dividendin, investimet në biznesin tonë, apo duke zgjeruar rrjetin. Deri tani, ne e kemi mbajtur premtimin tonë ndaj aksionerëve. Gjatë këtyre viteve të fundit banka ka arritur të ruajë një rritje të qëndrueshme të aktiveve.

Pavarësisht krizës financiare, rritja e aktiveve gjatë vitit 2011 ka ruajtur një normë prej 20%, ose katër herë më e lartë se sa mesatarja e sektorit bankar. Ishte vërtetë kënaqësi për ne që të shihnim se në fund të vitit 2011 banka jonë ishte një nga më fitimprurëset në Shqipëri për sa i përket Kthimit mbi Aktivet (RoA) si dhe Kthimit mbi Kapitalin Aksioner (RoE), ku marzhi i fitimit neto për vitin 2011 ishte më i larti i të gjitha viteve me 24%.

Fleksibilitet dhe përshtatje në aktivitetin bankar vendas

Duke qenë se shumica e aktivitetit bankar në Shqipëri kryhet nga banka ndërkombëtare klientët jo gjithmonë gjejnë shpejtësi dhe fleksibilitet në zgjidhjen e nevojave që dikton tregu vendas. Kjo nënkupton se politikat dhe procedurat bankare janë më pak të personalizuar me



Ne po japim kontributin tonë që ekonomia të ecë përpara.
Ne udhëhiqemi nga vizioni ynë, kemi një strategji për ta
realizuar dhe parime biznesi që na ndihmojnë të qëndrojmë të
përqëndruar drejt rritjes.

nevojat e biznesit vendas. Për më tepër, vendimarrja për çështje të rëndësishme biznesi, ndodh të bëhet jashtë Shqipërisë duke krijuar kështu një distancë kohore dhe shpesh edhe objektive, ndërmjet procesit të vendimarrjes së bankës dhe realitetit të nevojave të klientëve në Shqipëri. Banka jonë si njohëse dhe pjesë e kulturës vendase sigurisht ka edhe një vendimarrje të tillë. Kjo gjë na lejon që të përshtatemi më mirë me kushtet e vetë biznesit duke qenë kështu më të aftë t'u përgjigjemi shpejt dhe me fleksibilitet të lartë nevojave të klientëve.

Krijim i një kulture mbizotëruese gjithëpërfshirëse

Ne dëshirojmë që punonjësit tanë të ndjehen të përfshirë në biznes si dhe të kenë një ndjenjë pronësie të përbashkët. Kjo nënkupton domosdoshmërinë për t'u ofruar atyre trajnimin, zhvillimin dhe mbështetjen e nevojshme për të arritur rezultate pozitive si dhe për të krijuar një mjedis pune gjithëpërfshirës, me diversitet dhe të respektueshëm ku secili të mund të përmbushë potencialin e vet. Deri më tani ne kemi implementuar me sukses një Model Për Vlerësimin e Performancës (M2P) me synim promovimin e zhvillimit të punonjësve nëpërmjet një metode vlerësimi të lehtë për t'u ndjekur dhe të balancuar, si dhe një sistemi të orientuar nga tregu dhe transparent me incentivat. Gjithashtu, ne i bëmë ndryshime programit të përfitimeve të punonjësve, si për shëmbull mbulimi shëndetësor tashmë më pak i kushtueshëm për ta. Në vijim të këtij parimi për të përmirësuar politikat e burimeve njerëzore, së shpejti do të fillojmë edhe një sondazh për të gjithë punonjësit i cili do të na ndihmojë të kuptojmë se si mund të krijojmë një mjedis pune motivues. Një punonjës i motivuar, është një klient i kënaqur!

Duke parë nga e ardhmja



Siç e përmenda edhe më sipër, banka jonë sot është më e fortë se sa ishte një vit më parë. Ne shërbejmë qindra dhe mijëra klientë, biznese dhe institucione publike, ku secili prej tyre përbën një mundësi për ta zgjeruar marrëdhënien tonë më tej. Ndaj edhe ne nuk po i lëmë asgjë rastësisë në përpjekjet tona për t'i përmbushur këto mundësi.

Ky vit sjell sukseset dhe sfidat e veta, por drejtimi ynë është i qartë. Ne do vazhdojmë të fokusohemi fort tek gjërat që mund t'i kontrollojmë, si: ofrimi i shërbimit më të mirë dhe zgjidhjeve më të plota financiare në treg për klientët tanë; menaxhimi i kostove; dhe përmbushja e pjesës sonë në mbështetje të ecurisë së ekonomisë. Ky është investimi ynë i përkthyer në vlerë afatgjatë, me përmbushjen e të gjitha sa më sipër.

Ndërsa vazhdojmë punën mbi themelet që kemi vendosur, unë do desha të falenderoj klientët tanë për mundësinë që t'u shërbejmë nevojave të tyre; punonjësit tanë për punën e tyre të palodhur gjatë vitit të kaluar; si dhe aksionerët tanë për besimin e vazhdueshëm në të ardhmen e shkëlqyer të kompanisë sonë.

Ne udhëhiqemi nga vizioni ynë, kemi një strategji për ta realizuar dhe parime biznesi që na ndihmojnë të qëndrojmë të përqëndruar drejt rritjes. Unë gjithnjë mirëpres përshtypjet tuaja ndërsa ne vazhdojmë përpara së bashku!

Artan Santo
Drejtor i Përgjithshëm



Mesazh nga Këshilli Drejtues

Është kënaqësi e veçantë për ne të urojmë ekipin drejtues për arritjet e tyre gjatë vitit 2011! Ne gëzohemi për faktin se Credins bank në mënyrë të qëndrueshme rrit pozicionimin e saj në tregun bankar shqiptar për sa i përket totalit të aktiveve, kredive dhe depozitave. Vitin që shkoi, Credins bank u rendit ndër pesë bankat më të mëdha në Shqipëri dhe kjo për ne si Bord Drejtues është rikonfirmimi i besimit të klientëve ndaj bankës, si dhe i rezultateve shumë të mira nga përkushtimi i ekipit drejtues.



Jemi krenarë për ekipin drejtues që ka një vizion dhe strategji, e cila është konkrete dhe e arritshme.



Ju shprehim falenderim dhe mirënjohje klientëve dhe partnerëve, për besimin ndaj nesh dhe për bashkëpunimin reciprok.

Të nderuar aksionerë,

Gjatë vitit 2011, ne si Këshill Drejtues shqyrtuam dhe analizuam në detaje me ekipin drejtues, strategjinë dhe operimin e bankës. Në të gjitha takimet e zhvilluara gjatë vitit me ekipin drejtues, ata na raportuan mbi arritjet dhe çështjet kryesore për sa i përket menaxhimit dhe planifikimit korporativ, riskut të bankës, likuiditetit dhe menaxhimit të kapitalit si dhe transaksionet dhe aktivitetet e tjera me rëndësi për bankën. Ne ofruam këshillat tona për ekipin drejtues si dhe monitoruam menaxhimin e biznesit.

Në emër të Këshillit Drejtues të Credins bank, duam të shprehim mirënjohjen e thellë ndaj punonjësve të bankës për profesionalizmin, përkushtimin dhe prirjen drejt rezultateve. Gjithashtu, jemi krenar për ekipin drejtues që ka një vizion dhe strategji e cila është e përshtatshme dhe e arritshme. Jemi të bindur se ekipi drejtues është i aftë të zgjidhë çdo problem biznesi të çfarëdo lloji kompleksiteti, dhe falë këtij menaxhimi profesional, Credins bank arrin të ruajë pozicionimin si një ndër bankat më të besueshme në Shqipëri. Gjithashtu, dëshirojmë t'u shprehim falenderimin dhe mirënjohjen klientëve dhe partnerëve për besimin dhe për bashkëpunimin e ndërsjellë. Së bashku ne jemi gati për suksese të mëtejshme gjatë vitit 2012.

KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues i Credins bank zhvillon pesë deri në gjashtë mbledhje gjatë vitit. Anëtarët e këshillit përqëndrohen në çështje të rëndësishme për strategjinë e aksionerëve, menaxhimin e riskut, zhvillimin e lidershit dhe çështje rregullatore.



ILIRJAN BUSHATI
Kryetar i Këshillit Drejtues

- Anëtarët e këshillit përqëndrohen në:
- menaxhimin e riskut
 - zhvillimin e lidershit
 - çështje rregullatore



MALTIN KORKUTI
Anëtar



MONIKA MILO
Anëtare



SAJMIR SALLAKU
Anëtar



CLIVE MOODY
Anëtar



ELONA GJIKA
Anëtare



ANDON DAKA
Anëtar

STRUKTURA ORGANIZATIVE


Hallka më të shkurtra procesesh
çojnë drejt rritjes së fleksibilitetit
në vendimmarrje.

Me këtë objektiv në mendje, ne e rimodeluam strukturën organizative, mbështetur edhe në dëshirën për t'i sjellë bankës sinergji nga kostot dhe të ardhurat nëpërmjet shmangies së dublimeve dhe konkurrencës së brendshme të panevojshme. Që nga fillimi i vitit 2011, Banka u organizua për herë të parë në katër divizione: Divizioni i Zhvillimit të Biznesit, Divizioni i Kredisë, Divizioni Operacional dhe Divizioni Financiar.

Një vit më vonë, Banka është më e fortë dhe më e organizuar sesa më parë dhe si rrjedhojë është më e ndjeshme ndaj nevojave dhe preferencave të klientëve se sa çdo lojtar tjetër në treg.

Struktura e re i përshtat më mirë njësitë operationale të bankës, për t'ju përgjigjur më me efektivitet nevojave të klientëve.

Katër divizione: Divizioni i Zhvillimit të Biznesit, Divizioni i Kredisë, Divizioni Operacional dhe Divizioni Financiar.



SEGMENTET TONA TË BIZNESIT

BIZNESI

Nuk ka asgjë që bizneset e vogla, të mesme dhe korporatat e mëdha nuk mund ta gjejnë pranë Credins bank. Ne i ndihmojmë bizneset në çdo fazë të rritjes pasi jemi të vetëdijsëm që partneriteti i përditshëm me klientët tanë është rruga drejt suksesit të përbashkët dhe një të ardhmeje më të mirë.

Gjatë vitit 2011, ne ndihmuam me mijëra kompani që të siguronin kapitalin prej më shumë se 55 miliard Lekë, gjë e cila i mundësoi ata të rrisnin biznesin dhe të arrinin synimet e tyre. Klientët tanë e dinë se, kur bizneset e vogla apo të mëdha kanë nevojë për produkte të sofistikuar, shërbime apo këshilla, ekipi ynë bankar është në gjendje t'u ofrojë zgjidhje specifike të personalizuar që vijnë në përmbushje të nevojave në ndryshim.

Gjatë vitit 2011, ne krijuam produkte të personalizuar për sektorë specifikë ku përmendim zyrat e këmbimit FOREX, produkte investimi në thesar ose paketa për kompanitë farmaceutike apo ato për sektorin e agro-biznesit. Klientët tanë tashmë e njohin përkushtimin tonë për ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata që përqendrohen te nevojat e tyre strategjike dhe te krijimi i mundësive dhe zgjidhjeve.

Marrëveshja e bashkëpunimit, që u firmos ndërmjet Credins bank dhe Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) në Prill 2011, ndihmoi drejt kreditimit të mëtejshëm të bizneseve mikro dhe SME që operojnë në zonat rurale në katër rajone: Shkodër, Kukës, Dibër dhe Lezhë. Synimi i kësaj marrëveshje është reduktimi i qëndrueshëm i varfërisë në zonat rurale nëpërmjet ofrimit të mundësive për popullatën e varfër të këtyre zonave që të marrin pjesë ose të gjejnë punë në rrjetin e furnizimit rural duke qenë njëherazi konkurrues në aspektin tregtar.

Sektori i agro-biznesit ishte një segment tjetër të cilit i kushtuam vëmendje gjatë vitit 2011. Në mbështetje të politikave të qeverisë, si dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit të Biznesit Rural të Ministrisë së Bujqësisë, Credins bank ofroi financim për sektorët prioritarë për qeverinë shqiptare, ku përmendim: drufrutorët, arrorët, ullinjtë, vreshtaria, zarzavatet, serat, etj.

Në vitet në vazhdim synimi ynë është t'u ofrojmë klientëve tanë shërbimin më të mirë dhe produkte financiare nga më modernet në treg; ne do t'i përshtatemi çdo nevojë duke krijuar produkte të ndryshme për çdo klient sipas të ardhurave, profilit apo normës së riskut.



**Banka më
e shpejtë
në vend!**



Pespa Group u themelua në vitin 1995 dhe operon në procesimin dhe përpunimin e aluminit. Misioni i kompanisë është të zhvillojë dhe standardizojë më tej portofolin e vet të produkteve duke ofruar vlerën më të mirë për klientët e saj.

Credins bank e mbështeti kompaninë për vendosjen e themelit për zgjerimin e saj jo vetëm në Shqipëri por edhe në Ballkan. Kur z. Lavdosh Petoshati u pyet për bashkëpunimin e tij me Credins bank, ai u përgjigj: “është e besueshme, e përkushtuar, mbështetëse dhe mbi të gjitha jo burokratike, me pak fjalë: Banka më e shpejtë në vend.”



Me Credins bank unë shkoj përpara!




Në mbështetje të biznesit në zonat rurale si dhe në kuadër të marrëveshjes me MADA, fabrika e përpunimit të qumështit e cila operon në zonën e Shkodrës, na sjell dëshminë e pronarit z. Besim Geci si më poshtë: Puna me Credins bank ka qenë një eksperiencë pozitive për rritjen e biznesit tim. Do doja të nënvizoj bashkëpunimin e besueshëm dhe personelin profesionist. Unë besoj se komunikimi efikas është një pikë tjetër e fortë e marrëdhënies transparente që ne kemi vendosur me Credins bank.

Credins bank jo vetëm që na ka ofruar produktet dhe shërbimet bankare por gjithashtu edhe konsulencë për t'i shfrytëzuar më së miri këto produkte dhe shërbime posaçërisht për ne. Do doja të thoja me dy fjalë: Me Credins bank është më e lehtë të shkoj përpara!



Credins bank ne kemi besim te njëri-tjetri!



Ateami sh.p.k. shprehet nëpërmjet Drejtorit dhe ortakut të vetëm Z. Agim Hysa: Ne operojmë në sektorin minerar dhe unë kam gjetur te Credins bank zgjidhjet e duhura për nevojat specifike të kompanisë time. Bashkëpunimi ynë me Credins bank ka nisur gjashtë vite më parë dhe ka qënë mjaft i frytshëm. Do desha të theksoj se personeli i bankës i ka përmbushur nevojat tona duke qënë mjaft profesional, si dhe fakti që ekipi drejtues i bankës na ka mirëpritur gjithnjë duke i dëgjuar të gjitha kërkesat tona të biznesit. Funksionaliteti i procedurave në të gjitha transaksionet me Credins bank është diçka që duhet theksuar pasi gjithçka është e thjeshtë dhe praktike.

Besimi, vazhdimësia dhe qëndrueshmëria mund të ofrohen vetëm te Credins bank. Ndaj unë parapëlqej të them: ne kemi besim te njëri-tjetri!



*Një partner
i besueshëm
që çmon
kohën time!*





NPV International filloi të operojë në vitin 1994 duke ushtruar aktivitetin në qytetin e Korçës. Kompania është një nga fabrikat më të mëdha tekstile që operojnë në vend dhe ka një eksperiencë të gjatë në prodhimin e pëlhurave për klientë nga Gjermania, Holanda, Italia, Greqia dhe tregje të tjera europiane. Eksperienca dhe pasioni për cilësinë janë faktorë kyç që sigurojnë produkte të cilësisë së lartë që përmbushin kërkesat e klientëve të huaj. Credins bank ndihmon që kjo kompani të ketë fleksibilitetin e nevojshëm për ta arritur këtë.

Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë, z. Vangjush Kosti, shprehet se marrëdhënia me Credins bank është reciproke dhe përmend ndër të tjera linjën e kreditit për investim në makineritë e teknologjisë më të fundit e cila i mundësoi firmosjen e kontratave ambicioze me partnerë dhe investitorë të huaj.

Ai shprehet se: Credins bank është partneri ideal.



SEGMENTET E BIZNESIT

INSTITUCIONET PUBLIKE

Një nga linjat më të suksesshme të biznesit të Credins bank është marrëdhënia me Institucionet Publike. Këto marrëdhënie kanë ardhur gjithnjë e më shumë duke u forcuar nëpërmjet një menaxhimi të kujdesshëm të fondeve të buxhetit, ofrimi i paketave interesante për pagesat e punonjësve dhe lehtësimi i transaksioneve financiare me këto institucione. Të gjitha këto, janë tashmë shërbime tradicionale, që ofrohen nga Credins bank.

Në Credins bank, synimi ynë është të ofrojmë zgjidhjet e duhura sipas nevojave të klientëve, duke ofruar shërbim cilësor me çmim të ndershëm, si dhe t'u ofrojmë klientëve tanë vlerë të shtuar ndërsa ata fuqizojnë marrëdhënien me ne. Në këtë kuadër, në vitin 2010 u bë edhe prezantimi i “Paga Credins” që është një produkt i personalizuar për institucionet publike, i cili u përmirësua edhe më tej gjatë vitit 2011 dhe rezultoi në rritjen e numrit të punonjësve që zgjedhin ta marrin pagën nëpërmjet Credins bank. Më tej, zgjerimi i rrjetit të degëve tona në ambientet pranë disa institucioneve publike u tregon klientëve tanë se ne jemi pranë, për të përmbushur nevojat e tyre.

Kjo paketë shërbimi dhe produktesh e krijuar për këtë grup klientësh ka ardhur duke u përmirësuar dhe plotësuar nga viti në vit, ndërkohë që përkushtimi ynë për të ardhmen mbetet i njëjtë.



Paketat “Paga Credins” dhe “Elite Member”



- **Zgjidhjet e duhura**
- **Shërbim cilësor**
- **Produkte të personalizuara**
- **Përmbushje e nevojave të tyre**



SEGMENTET E BIZNESIT

INDIVIDË

Thelbi i shërbimeve bankare për individët është zgjerimi i marrëdhënieve ekzistuese shoqëruar me një gamë produktesh të reja dhe këshilla të personalizuar. Për sa kohë klientët na njohin dhe i njohim, marrin vlerë marrëdhëniet ekzistuese nëpërmjet ofrimit të shërbimeve sa më cilësore.

Aktualisht ne po u shërbejmë klientëve individë në shumë mënyra ku ndër të tjera përmendim: shtimin e rrjetit të ATM-ve, shërbime të shpejta lehtësuese mobile banking dhe E - banking. Ndërkohë, ne jemi gjithnjë duke investuar dhe përmirësuar shërbimin tonë. Ne ofrojmë një gamë të gjerë produktesh bankare për Individin ku përmendim: karta debiti VISA, karta krediti VISA, karta American Express, produkte dhe investime thesari. Zgjidhjet tona përfshijnë produkte dhe shërbime në cilëndo fazë që klientët tanë gjenden në jetën e tyre financiare. Duke filluar që nga klientët që nisin një marrëdhënie të parë me bankën, tek ata me nevoja më të sofistikuar bankare, ne mund të ofrojmë të gjitha kapacitetet e Credins bank aty ku ata janë.

Gjatë vitit 2011, ne kemi sjellë shumë produkte të reja si për shembull, Depozitën Kalendarike e cila u ofron klientëve mundësinë që të zgjedhin datën e maturimit të depozitës, pra fleksibilitet në menaxhimin e shpenzimeve të tyre. Ne kemi sjellë Kredinë për Kursim Energjie e cila ofron mundësi të reja për klientët si dhe për vetë bankën e cila planifikon të zbatojë një program të strukturuar për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës. Ne gjithashtu kemi sjellë financime për studentët duke ofruar skema bonusi për ata që dalin me rezultate të mira gjatë vitit të parë të studimeve nën sloganin “me Credins bank një student i mirë paguan më pak”.

Së fundmi, në kuadër të bashkëpunimit me Postën Shqiptare, ne kemi sjellë një kredi të veçantë që quhet “Shqipëria në moshën e internetit”. Ky produkt u krijua për t’u ofruar banorëve në zona të largëta rurale, pranë Zyrave Postare, mundësinë për të blerë me këste të vogla mujore pajisje elektronike si për shembull: kompjuter, laptop, celularë, etj.



Faleminderit Credins bank!



Marsela është klientja e parë e kredisë “Shqipëria në moshën e internetit”. Ajo shprehet kështu: “Mua mu dha mundësia të blija laptopin e teknologjisë së fundit me kredinë nga Credins bank që quhet “Shqipëria në moshën e internetit”. Kjo mundësi ishte një vlerë shtesë për mua pasi përfitova disa gjëra njëherësh: internet falas, këste të vogla mujore dhe mundësinë që t’i përfitoja këto shërbime te pragu i shtëpisë nëpërmjet shërbimit të postës. Ndaj i them faleminderit Credins bank që më mbështeti!”



***Credins bank
mundësoi
pushimet
e mia!***



Kredia për Pushime



Arbi është një student i sapo diplomuar që aktualisht punon në një agjenci dizajni. Ai shprehet kështu: “Kursimet e mia ishin modeste dhe “Kredia për Pushime” nga Credins bank ku unë kam edhe llogarinë e pagës, më kurseu paratë dhe pushimet e mia “të momentit të fundit” drejt një vendi fantastik. Me tre muaj pa këste mujore? Kjo më ndihmoi shumë! Faleminderit Credins bank që mundësove dëshirën time për pushime!”



Banka ime e preferuar që mbështet të ardhmen time!



Ejona është studente e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Ajo përfitoi nga skema e bonusit për kreditë për studentët me rezultate të larta shkollore. Kredia në këtë rast u përdor për ndjekjen e një kursi programi kompjuterik në fushën ku ajo studion. Ejona shprehet kështu: “Unë i jam mirënjohëse Credins bank për mbështetjen e dhënë, pasi më mundësoi mbulimin e shpenzimeve të këtij kursi pa i'u rënduar financiarisht familjes time. Kam bindjen se pas kësaj eksperience të parë me Credins bank ajo do të mbetet banka ime e preferuar në të ardhmen!”

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS

Përgjegjësia sociale dhe qëndrueshmëria në treg po bëhen koncepte thelbësore për Credins bank ndërsa ato përcaktojnë performancën afatgjatë të biznesit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave në të gjithë vendin. Ne jemi të vetëdijshëm që qëndrueshmëria nuk është diçka që arrihet në një moment të caktuar dhe pastaj thjesht ruhet; përkundrazi, ajo nënkupton një proces mësimi të vazhdueshëm që sjell ndryshime në objektivat dhe menaxhimin e bankës, në sjelljen me klientët dhe në përshtatjen e produkteve dhe shërbimeve. Ndaj edhe Credins bank ka si synim që të zbatojë në të ardhmen e afërt një program të strukturuar për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës (CSR).

Gjatë vitit 2011, ne zhvilluam mjaft nisma me sponsorizime sociale duke u siguruar që ato të ishin të baraspeshuara ndërmjet pesë shtyllave të filantropisë: ndihma në komunitet, artet, arsimi dhe sportet, kërkimi mjekësor dhe mjedisi.

NDIHMA NË KOMUNITET: NJË DORË MBËSHTETËSE

Credins bank është e përkushtuar ndaj sigurimit të mundësive për atë pjesë të shoqërisë me të ardhura të pamjaftueshme ekonomike apo probleme të ndryshme sociale. Kjo gjë realizohet nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe mbështetjes së komuniteteve vendase. Për shembull, ne prej kohësh jemi mbështetës të një sërë OJF-sh (si për shembull: Fshati SOS, SIFE dhe Kryqi i Kuq, dega Shkodër) të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë nevojat sociale të njerëzve të marginalizuar apo në mbështetje të fushatave të ndryshme humanitare.

ARTET: NË MBËSHTETJE TË KULTURËS

Banka gjithashtu gjatë vitit 2011 mbështeti artet performuese – për shembull: filmat, muzikën klasike – nëpërmjet partneritetit me institucione kryesore kulturore në Shqipëri. Konkretisht, banka dha një kontribut të konsiderueshëm në realizimin e koncertit të “the Winterreise” pranë Teatrit të Operas dhe Baletit si dhe për zhvillimin e filmave me metrazh të shkurtër që prodhohen nga studio “Papadhimitri Film Production”. Banka gjithashtu sponsorizoi projektin me titull “The International Competition of New Artists” (Konkursi Ndërkombëtar për Artistët e Rinj), në mbështetje të të rinjve, që u organizua nga “Tirana Balkan Talent” si dhe mbështeti ekspozitën e mbajtur në Universitetin Loyles të New Orleans, SH.B.A.

Ndihma në
komunitet

Artet, Arsimi
dhe Sportet

Kërkimi
mjekësor

Mjedisi



Credins bank i ka kushtuar një vëmendje të veçantë aktiviteteve artistike dhe sportive që janë në mbështetje të zhvillimit social-kulturor të vendit.



Ne kujdesemi për mjedisin! Kësaj here ne mbështetëm transportin ekologjik me biçikleta, si një simbol i uljes së ndotjes, si dhe për të treguar qytetari dhe një model evropian për zhvillimin social dhe mjedisor të komunitetit.

ARSIMI DHE SPORTET: MËSIMI I TË RINJVE DHE RITJA E KAPACITETEVE

Credins bank është e vetëdijshme se arsimi luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin social dhe rritjen ekonomike. Programet e saj për mbështetjen e sektorit arsimor kanë ndihmuar që të promovohet më tej emancipimi i rinisë, ku përmendim mbështetjen e saj për Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, mbështetjen për Institutin e Shkencave Politike në organizimin e një konference ndërkombëtare në Shqipëri si edhe për studime të rëndësishme që ofrojnë një emancipim me bazë politike. Në kuadër të aktiviteteve sportive, Banka ka vazhduar të japë mbështetjen e saj me skuadrën e voleybollit për meshkuj “Studenti” nëpërmjet mbështetjes financiare për zhvillimin e mëtejshëm profesional.

KËRKIMI MJEKËSOR: NË MBËSHTETJE TË HULUMTIMIT DHE ZHVILLIMIT (R&D)

Seminari në fushën e kirurgjisë estetike që u mbështet nga banka tregon për interesin e lartë në fushën e kërkimit mjekësor.

MJEDISI: RITJA E VETËDIJES

Gjatë vitit 2011, Credins bank prezantoi një iniciativë të re për të rritur vetëdijen për çështjet e mjedisit. Në përmbushje të këtij synimi banka sponsorizoi organizatën “PASS” me qëllim zbatimin e projektit “Stacionet e Biçikletave në Tiranë”, i cili synon të nxisë transportin ekologjik. Credins bank i ka kushtuar një vëmendje të veçantë aktiviteteve artistike dhe sportive që janë në mbështetje të zhvillimit socialo-kulturor të vendit. Ne kujdesemi për mjedisin! Kësaj here ne mbështetëm transportin ekologjik me biçikleta si një simbol i uljes së ndotjes si dhe për të treguar qytetari dhe një model evropian për zhvillimin social dhe mjedisor të komunitetit.



TREGUESIT KRYESORË FINANCIAR


Credins bank është ndër institucionet financiare kryesuese në Shqipëri që u shërben të gjithë klientëve duke u ofruar një gamë të plotë produktesh dhe shërbimesh bankare. Gjatë tre viteve të fundit Credins bank është ngjitur në pozicionimin e saj brenda tregut bankar shqiptar për sa i përket totalit të aktiveve, kredive dhe depozitave. Gjatë vitit 2011 kemi tërhequr më shumë klientë duke zgjeruar rrjetin tonë, duke rritur mbështetjen për ekonominë shqiptare, si dhe duke forcuar më tej bilancin tonë financiar dhe pozicionimin e kapitalit me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për një rritje afatgjatë të vlerës për aksionerët.

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË TË VITIT BILANCI (LEK'ooo)


	2011	2010	Y-Y
			Ch (%)
Hua dhe paradhënie për klientët	62,388,875	42,479,386	47%
Fondi për humbje nga zhvlerësimi i huave	(3,757,179)	(2,221,245)	69%
Net Hua dhe paradhënie për klientët	58,631,696	40,258,141	46%
Investime në instrumenta financiarë	6,263,167	7,862,162	-20%
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10,190,044	15,358,495	-34%
Totali i Aktiveve	84,217,207	71,020,392	19%
Detyrimet ndaj bankave	2,406,500	1,847,413	30%
Detyrime ndaj klientëve	71,395,156	62,165,614	15%
Borxhi i varur	2,216,690	1,428,559	55%
Kapitali aksionar	3,784,305	3,507,786	8%
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar	7,629,897	5,386,856	42%
	2011	2010	Y-Y
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE			Ch (%)
Të ardhura neto nga interesat	4,075,474	2,695,092	51%
Humbje nga zhvlerësimi i huave (provigjione net)	(1,580,269)	(1,222,660)	29%
Të ardhura neto nga komisionet	304,145	265,464	15%
Të ardhura të tjera bankare	692,492	424,714	63%
Fitimi para tatimit	1,826,369	746,991	144%
Shpenzime tatimi mbi fitimin	(170,142)	(79,586)	114%
Fitimi neto i periudhës	1,656,227	667,405	148%
	2011	2010	Y-Y
ÇELSAT E PERFORMANCES (%)			Ch (bp)
ROA	2.13%	1.10%	94%
ROE	25.43%	14.62%	74%
Marzhi neto i interesave	5.25%	4.45%	18%
Marzhi kosto / të ardhura	32.41%	41.52%	-22%
Yield –i portofolit	11.67%	11.97%	-3%
Kosto interesi / pasive	4.03%	4.35%	-7%
	2011	2010	Y-Y
BILANCI - RAPORTE NË (%)			Ch (bp)
Portofoli / Mjetet	74.08%	59.86%	24%
Kredi / Depozita	86.85%	68.00%	28%
Mjaftueshmëria e kapitalit (BSH)	13.92%	13.40%	4%
	2011	2010	Y-Y
TREGUESIT E CILËSISË SË AKTIVAVE (%)			Ch (bp)
Portofoli me risk 30 dite ne %	14.06%	10.62%	32%
Portofoli me risk > 30 dite ne %	16.00%	17.97%	-11%
Kreditë me probleme ne %	10.79%	10.41%	4%
Hua të zhvlerësuar / Total portofoli	6.02%	5.23%	15%

Credins bank si një ndër institucionet kryesore financiare në Shqipëri ofron një gamë të plotë produktesh dhe shërbimesh bankare.

FITIMI NETO (në miliard, fundi i vitit)



PJESA E KAPITALIT TË AKSIONERËVE (në miliard, fundi i vitit)




TË DHËNAT KRYESORE PËR SEGMENTIN BIZNES DHE RETAIL


	2011	2010
Numri total i klientëve	168.489	125.737
Depozitat dhe Llogaritë në '000 LEK	71.395.156	62.165.614

BIZNES DHE RETAIL	2011		2010	
Të dhëna kredie	Portofoli Bruto në '000 ALL	Klientët numër	Portofoli në '000 ALL	Klientët numër
Kredi për Individë	7,284,271	14,127	5,924,749	8,827
Kredi Mikro	1,800,954	3,573	1,322,955	2,919
Kredi SME	9,537,100	881	8,577,381	797
Kredi për Korporatat	43,766,550	357	26,654,300	289
Total Portofoli	62,388,875	18,938	42,479,385	12,832

NUMRI I DEGËVE PËR RAJONE





NUMRI I STAFIT PËR RAJONE



OBJEKTIVAT PËR VITIN 2012

Sa më pranë klientëve tanë të jemi aq më shumë do jemi të vëmendshëm ndaj nevojave të tyre. Me këtë objektiv në mendje ne do vazhdojmë të zgjerojmë modelin e biznesit të mbështetur në një strukturë organizative të ndarë në divizione me qëllim lehtësimin e punës për klientët ndërsa bëjnë biznes me ne. Gjithashtu, gjatë vitit 2012, kemi planifikuar një projekt interesant për krijimin e funksionit të Menaxhimit të Marrëdhënies me Klientin, i cili do ta përmirësojë edhe më tej fokusin tonë ndaj kënaqësisë së klientit. Rrjeti i degëve tona kësaj here do të kalojë kufirin Shqiptar, teksa ne synojmë të fillojmë të operojmë edhe në vende të tjera të Ballkanit.



Në vitin 2012, kemi në objektiv të ofrojmë një zgjidhje të re për e-banking. Kjo zgjidhje jemi të bindur që do të rrisë edhe më tej kënaqësinë e klientëve, nëpërmjet ofrimit të më shumë shërbimeve dhe faciliteteve, njëkohësisht edhe rritjes së sigurisë online dhe të gjitha këto me çmime më konkurruese. Liçencat për pranimin e pagesave në pika shitje POS (Merchant acquiring) është një sfidë tjetër e madhe për vitin 2012. Ne synojmë të hyjmë në treg në një kohë kur lojtarët e tjerë janë stabilizuar sakaq, ndërsa vetë tregu shqiptar nuk është maturuar ende, por ne mbetemi të bindjes së ka ende shumë mundësi dhe tregje të reja që do të ndihmojnë në forcimin e marrëdhënies me klientët tanë dhe ata do na ndihmojnë të rritemi. Një objektiv tjetër i rëndësishëm është futja në treg e kartës së parapaguar VISA që do të jetë e disponueshme për të gjithë klientët dhe jo-klientët si një produkt për herë të parë për të gjithë tregun bankar shqiptar.

Ne duhet të përforcojmë faktin se çdo punonjës është një shtysë e rëndësishme në performancën afatgjatë të bankës dhe që udhëheqja dhe bashkëpunimi në të gjitha nivelet dhe divizionet i shërben përmbushjes më të mirë të nevojave të klientëve. Me synim arritjen e këtyre objektivave, banka do të nisë një sondazh për të gjithë punonjësit, i cili do të sigurojë një informacion gjithëpërfshirës me anë të të cilit ne do mund të marrim masa konkrete për t’u përmirësuar. Më tej, Banka gjatë vitit do të organizojë edhe programe trajnimi për punonjësit në fushën e “soft-skills” pasi kjo do ti rrisë edhe më tej përfitimet për ta dhe vetë organizatën.

Deri tani ne jemi angazhuar në mbështetje filantropike dhe në aktivitete me synim mbrojtjen e ambientit ose nevojat e familjeve, por besojmë se duhet bërë edhe më shumë. Ne synojmë të implementojmë një program më të strukturuar për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës (CSR) pasi besojmë se ky program është pjesë përbërëse e rritjes dhe suksesit afatgjatë të biznesit dhe se luan një rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave tona në të gjithë vendin.

TOTALI I DEPOZITAVE
(në miliard)

86



2012

21% ↑

TOTALI I AKTIVEVE
(në miliard)

101



2012

19% ↑

TOTALI I PORTOFOLIT
TË KREDIVE
(në miliard)

72



2012

24% ↑

ADRESAT

ZYRA QENDRORE

DEGA TIRANA 1

Rruga “Ismail Qemali”, Nr 4, Tiranë. Tel. (04)22 34 096; 069 20 69666;
(04) 22 50 994; Fax. (04) 22 22 916; SWIFT Code: CDISALTR
www.bankacredins.com; info@bankacredins.com

DEGA TIRANA 2

Bulevardi “Zogu i I”, Qendra VeVe, Tiranë
Tel. (04) 22 58 252; (04) 22 57 988; Fax. (04) 22 48 654.

DEGA TIRANA 3

Kryqëzimi “21-Dhjetorit”, Tiranë. Tel. (04) 22 39 042. Fax. (04) 22 38 995

DEGA TIRANA 4

Rruga “Komuna e Parisit”, Tiranë. Tel. (04) 23 20 234, Fax. (04) 23 20 233

DEGA TIRANA 5

Rruga “Elbasanit”, pranë “Shkollës së Baletit”, Tiranë
Tel/Fax. (04) 23 47 809

DEGA TIRANA 6

Brenda Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë
Tel/Fax. (04) 23 76 305

DEGA TIRANA 7

Rruga “Bardhyl”, (tek kryqëzimi i Rugës “Bardhyl” me
Rrugën “Hoxha Tahsim”) Tiranë. Tel. (04) 23 47 572

DEGA TIRANA 8

Rruga “Bajram Curri”, pranë kryqëzimit të “Shkollës së Bashkuar”, Tiranë
Tel/Fax. (04) 23 47 560

DEGA TIRANA 9

Rruga “Ferrit Xhajko”, (ish-Frigoriferi), Tiranë. Tel. (04) 22 48 485

DEGA TIRANA 10

Rruga “Gjin Bue Shpata”, pranë stadiumit Selman Stermasi, Tiranë
Tel/Fax. (04) 22 56 694

DEGA TIRANA 11

Pranë Shkollës “Harry Fultz”, Rruga “Jordan Misja”, Tiranë
Tel. (04) 22 35 439, Fax. (04) 22 30 756

DEGA TIRANA 12

Rruga “Myslym Shyri”, Tiranë. Tel. +355 4 24 21 223 Fax. +355 4 24 21 221

DEGA TIRANA 13

Rruga “Don Bosko”, Tiranë Tel. +355 4 240 6367 Fax. +355 4 240 6368

DEGA TIRANA 14

Rruga “Luigj Gurakuqi”, pranë Ushtarit të Panjohur, Tiranë
Tel: (04) 22 58 128, Fax: (04) 22 57 995

DEGA TIRANA 15

Bulevardi “Gjergj Fishta”, Tiranë. Tel/Fax: (04) 24 19 672

DEGA TIRANA 16

Tek Blloku “Gintash” (dykatëshet) në Laprakë, Tiranë
Tel : (04) 23 56789, Fax : (04) 23 56 285

DEGA VORË

Tel. (047) 26 00 435; Fax. (047) 26 00 422.

DEGA FUSHË - PREZË

[Tek Kolaudimi i Automjeteve](#)

DEGA KAMËZ

Në qendër të Kamzës. Tel. (04) 22 00 485; Fax. (04) 22 00 487

AGJENCIA 1 TIRANË

Autostrada Tiranë – Durrës, Km 11, pranë Emigres Sh.p.k.
Tel/Fax. (048) 23 01 260



Hapja e agjencive të reja si përgjigje e strategjisë për ti ardhur më pranë biznesit dhe kërkesave të tij.



Rrjeti ynë u zgjerua me këto agjenci të reja gjatë 2011:
 ➤ Agjencia Fushë Prezë
 ➤ Agjencia ZRPP Shkodër
 ➤ Agjencia QKR

AGJENCIA 2 TIRANË

AGJENCIA QKR

DEGA DURRËS

Agjencia tek Hipoteka e Tiranës

Pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve, Tiranë

Bulevardi kryesor, Rruga Tregtare, Nr 42, Durrës

Tel. (052) 236 256, (052) 239 925; Fax. (052) 239 500.

AGJENCIA PORTI DURRËS

Tek sheshi i trageteve në Portin detar, Durrës. Tel/Fax. (052) 234 500

AGJENCIA TREGU

INDUSTRIAL DURRËS

Pranë Qendrës Tregtare Industriale, Lagjja 17, Rr. Unazës, Durrës

Tel/Fax. (052) 236 257

DEGA SHKOZET

Lagja 14, Përballë Shkollës së Mesme “Olsi Lasko”, Shkozet, Durrës

Tel. (052) 237 668; Fax. (052) 237 669

DEGA SHIJAK

Lagjja “Kodër”, Shijak. Tel. (0571) 23 069; Fax. (0571) 23 070

DEGA KAVAJË

Lagjja Nr. 5, Kavajë. Tel. (0554) 227 858; Fax. (0554) 227 859

DEGA FUSHË - KRUIJË

Lagjja “Kastrioti”, Fushë - Krujë. Tel. (0563) 22 489; Fax. (0563) 22 490

DEGA FIER

Bulevardi “Jakov Xoxe”. Tel. (034) 29 131; (034) 29 132; Fax. (034) 229 130

DEGA LEZHË

Lagjja “Besëlidhja”, Rruga “Luigj Gurakuqi” Nr 48

Tel. (0215) 23 500; Fax. (0215) 23 600

DEGA VLORË 1

Lagjja “Pavarësia”, Banesë 12 katëshe, Skelë, Vlorë.

Tel. (033) 229 958; Fax. (033) 229 959

DEGA VLORË 2

Rruga “Demokracia”, Lagjja. “Osmen Haxhiu”, Vlorë. Tel. (033) 237 170

DEGA ELBASAN

Lagjja “Aqif Pasha”, Rruga 28 Nëntori, (pranë Drejtorisë së Policisë).

Tel. (0544) 224 213; (0544) 24 472; Fax. (0544) 24204.

DEGA SHKODËR

Lagjja “Vasil Shanto”, Rruga “Vaso Kadia”

Tel. (022) 250 643; (022) 250 645; Fax. (022) 250 633

AGJENCIA SHKODËR

Pranë hipotekës

DEGA KORÇË

Bulevardi “Republika”, Lagja 12, (tek “Ish-Vetëshërbimi”)

Tel. (082) 254 300; Fax. (082) 254 400

DEGA LUSHNJE

Bulevardi Kryesor, Ish-Hotel Myzeqeja, Tel. (022) 2986; Fax. (022) 2983

DEGA KUKËS

Lagjja Nr.2 Pallati 67. Tel. (024) 224 903, Fax. (024) 224 904

DEGA BURREL

Lagjja “Pjeter Budi”. Tel/ax: (02172) 3404, Fax: (02172) 3414

DEGA BALLSH

Lagjja “5 Shkurti”. Tel: (0313) 23642, Fax: (0313) 23643

DEGA PESHKOPI

Bulevardi “Elez Isufi”. Tel: (0128) 25624, Fax: (0218) 25625

DEGA BERAT

Lagjja “22 Tetori”, Shëtitorja kryesore, Tel: (0322) 34 612, Fax: (0322) 34718

PASQYRAT FINANCIARE
DHE RAPORTI I AUDITIT
MBYLLUR MË
31 DHJETOR 2011

А. С. О. У. Р. А. Т. Е.
Н. Е. Р. А. П. О. Р.
31 М. Б. У. Л. Е.

FINANCIARIE
TURAM
2011

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	
PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT	
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	
1	INFORMACION I PËRGJITHSHËM
2	POLITIKAT KONTABËL
2.1	BAZAT E PËRGATITJES
2.2	PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE
2.3	NDRYSHIMET NE POLITIKAT KONTABËL DHE SHPJEGIMET
2.4	PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
3	TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA INTERESAT
4	TË ARDHURA DHE SHPENZIME NGA TARIFAT DHE KOMISIONET
5	SHPENZIME PERSONELI
6	SHPENZIME ADMINISTRATIVE
7	SHPENZIMET E TATIMEVE MBI TË ARDHURAT
8	MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO
9	SHUMA TË KUSHTËZUARA ME BANKËN QËNDRORE
10	HUA DHE PARADHËNIE BANKAVE DHE INSITUCIONEVE FINANCIARE
11	HUA DHE PARADHËNIE KLIENTËVE
12	LETRA ME VLERË TË INVESTUARA
13	AKTIVE MATERIALE
14	AKTIVE JO-MATERIALE
15	AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA
16	AKTIV AFATGJATË MATERIAL I INVESTUAR
17	AKTIVE TË TJERA
18	DETYRIMET NDAJ BANKAVE
19	HUATË
20	DETYRIME NDAJ KLIENTËVE
21	DETYRIME TË VARURA
22	DETYRIME TË TJERA
23	PROVIZIONET
24	TEPRICA E KAPITALIT
25	KAPITALI AKSIONAR
26	REZERVA TË PËRGJITHSHME
27	ANALIZË MATURIMI PËR AKTIVET DHE DETYRIMET
28	ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA
29	SHËNIME PËR PALËT E LIDHURA
30	NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT
31	ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR
31.1	NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM
31.2	RREZIKU I KREDISË
31.3	RREZIKU I LIKUIDITETIT
31.4	RREZIKU I TREGUT
31.5	RREZIKU OPERACIONAL
31.6	MENAXHIMI I KAPITALIT
31.7	SHËNIME SHPJEGUESE PËR VLERËN E DREJTË

**RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR PER AKSIONARET E
CREDINS BANK SH.A.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Credins Bank Sh.A. ("Banka") të cilat përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2011, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit, dhe pasqyrën e fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është që, duke u bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme, dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej mashtrimit apo gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë për gjendjen financiare të Bankës më datë 31 Dhjetor 2011, dhe për ecurinë financiare të saj, dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Credins Bank Sh.A., për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010, janë audituar nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra më 22 Prill 2011.

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k. Skopje - Tirana Branch

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k.

23 Mars 2012

Credins Bank Sh.a.

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011¹

	Shënime	Viti i mbyllur më 31/12/11 Lek'000	Viti i mbyllur më 31/12/10 Lek'000
Të ardhura nga interesat	3	6,938,516	5,130,222
Shpenzime për interesat	3	(2,863,042)	(2,435,130)
Të ardhura neto nga interesat	3	4,075,474	2,695,092
Të ardhura nga komisionet	4	388,099	315,882
Shpenzime për komisionet	4	(83,955)	(50,418)
Të ardhura neto nga komisionet	4	304,145	265,464
Shpenzime të tjera, neto		26,126	343
Fitimi nga kurset e këmbimit		666,366	424,371
Të ardhura të tjera bankare		692,492	424,714
Humbje nga zhvlerësimi i huave, neto	11	(1,580,269)	(1,222,660)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	14	(13,839)	(9,807)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	13	(133,594)	(128,469)
Shpenzime personeli	5	(654,042)	(546,171)
Shpenzime të përgjithshme administrative	6	(863,997)	(731,172)
		(3,245,741)	(2,638,279)
Fitimi para tatimit		1,826,369	746,991
Shpenzime tatimi mbi fitimin	7	(170,142)	(79,586)
Fitimi neto i periudhës		1,656,227	667,405
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje	12	(72,636)	28,041
Kthimi i diferencave të rivlerësimit njohur për instrumentat e riklasifikuar		18,610	-
(Shpenzime tatim fitimi) / Të ardhura lidhur me komponentët e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		5,403	(2,804)
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje, pas tatim fitimit		(48,623)	25,237
Të ardhura të tjera, pas tatimit mbi fitimin	12	(48,623)	25,237
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për pronarët, pas tatimit mbi fitimin		1,607,604	692,641

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi Drejtues i Credins Bank Sh.A më 23 Mars 2012 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Artan Santo

Drejtor i Përgjithshëm

Valentina Prodani

Drejtoresh e Financës dhe Kontabilitetit

¹ Shënimet 1 deri 31 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2011²

Aktivët	Shënime	31/12/11 Lek'000	31/12/10 Lek'000
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	8	10,190,044	15,358,495
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	9	6,819,230	5,653,566
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	10	1,096,626	676,868
Hua dhe paradhënie për klientët	11	58,631,696	40,258,141
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	12/1	4,109,267	7,862,162
Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim	12/2	2,153,900	-
Aktive afatgjata materiale	13	752,171	786,486
Aktive afatgjata jomateriale	14	45,681	31,039
Të drejta tatimore të shtyra	15	-	540
Te drejta tatimore korrente	15	-	46,807
Aktive afatgjata materiale të investuara	16	210,556	186,493
Aktive të tjera	17	208,035	159,795
Totali i aktiveve		84,217,207	71,020,392
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave	18	2,406,500	1,847,413
Hua	19	125,447	134,427
Detyrime ndaj klientëve	20	71,395,156	62,165,614
Borxhi i varur	21	2,216,690	1,428,559
Detyrime korrente tatimore	7	51,886	-
Detyrime tatimore të shtyra	15	4,707	-
Detyrime të tjera	22	375,667	46,437
Provizione	23	11,257	11,086
Totali i detyrimeve		76,587,310	65,633,536
Kapitali			
Kapitali aksionar	24,25	3,784,305	3,507,786
Primi i aksioneve	25	813,200	336,334
Rezerva e përgjithshme	26	962,800	797,679
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	12	29,029	77,652
Fitime të pashpërndara		2,040,563	667,405
		7,629,897	5,386,856
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar		84,217,207	71,020,392

² Shënimet 1 deri 31 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011³

	Kapitali aksionar Lek'000	Primi i lidhur me aksionin Lek'000	Rezerva e përgjithshme Lek'000	Rezerva rivlerësimi Lek'000	Fitimi i pashpërndarë Lek'000	Totali Lek'000
Gjendja më 1 Janar 2010	2,404,771	336,334	412,940	52,415	524,765	3,731,225
Fitimi i vitit	-	-	-	-	667,405	667,405
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse nga rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-	-	25,237
Përvetësimi fitimit të pashpërndarë	140,026	-	384,739	-	(524,765)	-
Rritje kapitali	962,990	-	-	-	-	962,990
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	3,507,787	336,334	797,679	77,652	667,405	5,386,857
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	106,153	-	165,121	-	(271,274)	-
Dividendë	-	-	-	-	(11,795)	(11,795)
Emetim i aksioneve të reja	170,365	476,866	-	-	-	647,231
Fitimi i vitit	-	-	-	-	1,656,227	1,656,227
Të ardhura të tjera / (shpenzime të tjera) gjithëpërfshirëse nga rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	(48,623)	-	(48,623)
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	3,784,305	813,200	962,800	29,029	2,040,562	7,629,897

³ Shënimet 1 deri 31 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011⁴

	Shënime	Viti i mbyllur më 31/12/11 Lek'000	Viti i mbyllur më 31/12/10 Lek'000
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i periudhës		1,656,227	667,405
<i>Rregullimet për:</i>			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	13,14	147,433	138,276
Aktivitet afatgjatë të nxjerra jashtë përdorimi	13,14	10,163	623
Zhvlerësimi i instrumentave financiarë	11	1,580,269	1,222,660
Hua të fshira	11	(47,663)	(314,876)
Të ardhurat neto nga interesat	3	(4,075,474)	(2,695,092)
Shpenzime tatim fitimi	7	170,142	79,586
Efekti i kursit të këmbimit në borxhin e varur		2,548	6,672
Ndryshimi në hua dhe paradhënie bankave		(422,618)	(437,254)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie klientëve		(19,677,704)	(10,124,322)
Ndryshimi në shumat e kushtëzuara me Bankën e Shqipërisë		(1,165,476)	(1,486,151)
Ndryshimi në aktivet afatgjatë materiale të investuara		(24,063)	(98,417)
Ndryshimi në aktive të tjera		(48,240)	2,122
Ndryshim në detyrimet ndaj bankave		554,106	818,995
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve		9,064,347	18,642,944
Ndryshimi në detyrime të tjera		329,401	2,197
Interesi i arkëtuar		6,748,246	4,242,572
Interesi i paguar		(2,700,918)	(2,115,026)
Tatim fitimi i paguar		(66,203)	(42,761)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		<u>(7,965,477)</u>	<u>8,510,153</u>
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Shitje/(blerje) e letrave me vlerë		1,563,481	(4,291,082)
Blerje e aktiveve afatgjatë materiale	13	(109,442)	(155,067)
Blerje e aktiveve afatgjatë jomateriale	14	(28,481)	(2,353)
Flukset monetare neto nga / (në) aktivitetet investuese		<u>1,425,558</u>	<u>(4,448,501)</u>
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Kapital i paguar		586,813	962,990
Instrumenta financiarë (Borxh i varur)		784,655	-
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese		<u>1,371,468</u>	<u>962,990</u>
Rritje neto në aktive monetare dhe ekuivalente me to		(5,168,451)	5,024,642
Aktive monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		15,358,495	10,333,853
Aktive monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	8	<u>10,190,044</u>	<u>15,358,495</u>

⁴ Shënimet 1 deri 31 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Credins Bank Sh.A. (këtej e tutje "Banka") është një institucion financiar Shqiptar i themeluar më 1 Prill 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 Mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", miratuar në Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në Dhjetor 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë" (këtej e tutje referuar si "Banka Qendrore").

Me 31 Dhjetor 2011, Banka ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet drejtorisë së përgjithshme të saj në Tiranë, 38 degëve në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Shijak, Shkozë, Kavajë, Lushnjë, Fushë Krujë, Kukës, Burrel, Ballsh, Berat, dhe Peshkopi si dhe 6 agjencive në Tiranë, Shkodër dhe Portin e Durrësit (31 Dhjetor 2010: 36 degë dhe 5 agjenci).

Më 31 Dhjetor 2011 Banka kishte 589 punonjës (31 Dhjetor 2010: 516 punonjës).

Adresa e zyrave qendrore të bankës dhe vendit kryesor të ushtrimit të aktivitetit është: Rr. Ismail Qemali Nr. 21, Tiranë, Shqipëri.

2. POLITIKAT KONTABËL

2.1 BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të investuara dhe aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të matura me vlerë të drejtë.

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lek, i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(i) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

(ii) Paraqitja e pasqyrave financiare

Banka e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (korrente), dhe më vonë se 12 muaj nga data e pasqyrave financiare (jo korrente) paraqitet në shënimin 26.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Bankës.

Banka ka kryer disa riklasifikime për një paraqitje më të mirë krahasuese, mes "Shpenzimeve të përgjithshme administrative" (Shënimi 6) dhe "Shpenzimeve të personelit" (Shënimi 5).

2.2 PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të bankës, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

(I) Parimi i vijimësisë

Drejtimi i bankës ka kryer një vlerësim të aftësisë së bankës për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që banka ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.2 PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

(II) Vlera e drejtë e instrumentave financiarë

Politika kontabël e bankës lidhur me vlerësimin me vlerën e drejtë është diskutuar në Përmbledhje e Politikave të Rëndësishme Kontabël 2.4(IV). Banka e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: Çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku kërkojnë korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontimit të flukseve monetare, krahasim me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuar në një kurbë të kthimit aktual të përshtatshme për afatin e mbetur deri në maturim. Supozimet dhe input-et e përdorura në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat pa risk të interesit dhe normat e interesit referencë, marzhin e kreditit dhe primeve të tjera të përdorura në vlerësimin e normave të skontimit, çmimet e kapitalit dhe obligacioneve, kurset e këmbimit valutor të monedhës, çmimet e kapitalit dhe indeksit të kapitalit të vet dhe luhatjet e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, vlerë e cila do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrësit e tregut që veprojnë në mënyrë të vullnetshme dhe janë të palidhur më njëri-tjetrin.

Çmimet e vëzhgueshme dhe input-et e modelit janë zakonisht të disponueshme në treg për obligacionet e listuara dhe letrat me vlerë të kapitalit, për derivativet e këmbeshme në treg dhe derivativet e thjeshta “mbi banak”, si për shembull kontratat “swap” të normave të interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe input-eve të modelit zvogëlon nevojën për gjykim dhe vlerësim të drejtimit si dhe zvogëlon pasigurinë në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të tregut të vëzhgueshme dhe input-eve ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme në tregjet financiare.

Më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 të gjithë instrumentat financiarë janë matur me kosto të amortizuar përveç letrave me vlerë të vlefshme për shitje dhe aktiveve afatgjata materiale të investuara, për të cilat vlerat e drejta përkatëse janë paraqitur në shënimin 16. Vlerat e drejta më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 janë matur bazuar në Nivelin 2 të hierarkisë.

(III) Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Banka rishikon portfolet e saj të kredisë në baza mujore për të vlerësuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Banka bën gjykime për të parë nëse ka ndonjë të dhënë të vrojtueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme nga një portofol kredisë para se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale në këtë portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vrojtueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në një bankë, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e huave nga huamarrësit.

(IV) Zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje

Banka shqyrton letrat e saj të borxhit të klasifikuara si investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje në çdo datë të pasqyrave financiare për të vlerësuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të ngjashëm si ai i përdorur për vlerësimin individual të huave dhe paradhënieve.

Banka regjistron humbje nga zhvlerësimi i instrumentave të kapitalit të vlefshme për shitje kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur të vlerës së drejtë të tyre nën koston e tyre. Përcaktimi i asaj që është “i rëndësishëm” apo “i zgjatur” kërkon gjykim. Në marrjen e këtij vendimi, banka vlerëson, përveç faktorëve të tjerë, lëvizjet historike në çmimin e aksionit dhe kohëzgjatjen, si dhe masën në të cilën vlera e drejtë e një investimi është më e ulët se kostoja e tij.

(V) Tatimi i shtyrë

Aktivitet tatimore të shtyra njihen në lidhje me humbjet tatimore deri në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të përdoren. Gjykimi është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e aktiveve tatimore të shtyra që mund të njihen, bazuar në kohën e mundshme dhe nivelin e fitimit të tatueshëm të ardhshëm, së bashku me strategjitë e ardhshme të planifikimit tatimor.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.3 NDRYSHIMET NE POLITIKAT KONTABËL DHE SHPJEGIMET

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Bankës.

Deklarata të reja (standarde të reja, ndryshimet/rishikimet e standardeve ose interpretimeve të tyre) në fuqi për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2011.

(i) Standarde të publikuara që kanë hyrë në fuqi

Interpretimet dhe amendimet (ndryshimet) e standardeve të mëposhtme u bënë të detyrueshme për herë të parë për vitin financiar të filluar më 1 Janar 2011:

- **SNK 24 “Dhënia e Informacioneve për Palët e Lidhura” (Rishikuar)**
BSNK nxori një amendim për SNK 24 i cili sqaron përkufizimin e një pale të lidhur. Përkufizimi i ri thekson një këndvështrim simetrik të marrëdhënieve me palë të lidhura dhe sqaron rrethanat në të cilat personat dhe drejtuesit kryesorë ndikojnë në marrëdhëniet me palët e lidhura të një subjekti. Gjithashtu, amendimi prezanton një përjashtim nga kërkesat për dhënie të informacionit për transaksionet me qeverinë dhe subjektet të cilat kontrollohen, kontrollohen së bashku ose kanë ndikim të madh nga e njëjta qeveri si subjekti raportues. Amendimi aplikohet në bazë retrospektive. Amendimi është vlerësuar se nuk do të ketë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.
- **SNK 32 Instrumentat Financiare: Paraqitja – (Rishikuar)**
BSNK nxori një amendim i cili ndryshon përkufizimin e një detyrimi financiar të SNK 32 për të bërë të mundur që subjektet të klasifikojnë emetimin e të drejtave dhe disa opsione ose garanci të caktuara si instrumenta kapitali. Amendimi është i zbatueshëm nëse këto të drejta janë dhënë në mënyrë proporcionale tek të gjithë pronarët ekzistues të së njëjtës klase të instrumentave jo-derivativë të kapitalit të subjektit, ose për të blerë një numër të caktuar të instrumentave të kapitalit të vetë njësisë për një shumë të caktuar në çfarëdo monedhë. Ky amendim aplikohet në mënyrë retrospektive. Amendimi është vlerësuar se nuk do të ketë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

(ii) Standarde të publikuara që nuk kanë hyrë akoma në fuqi

Standardet e publikuara që nuk kanë hyrë akoma në fuqi deri në datën e hartimit të pasqyrave financiare të bankës paraqiten më poshtë. Kjo listë paraqet standardet dhe interpretimet e publikuara, të cilat Banka pritet t'i zbatojë në të ardhmen. Banka planifikon t'i adoptojë këto ndryshime në momentin e hyrjes së tyre në fuqi.

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Rishikuar) - Paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse.**
Amendimi hyn në fuqi për periudhat vjetore të cilat fillojnë në datën ose pas datës 1 Korrik 2012. Ndryshimet e SNK 1 ndryshojnë klasifikimin e zërave të cilët paraqiten në të ardhurat e tjera përmbledhëse. Zërat të cilët mund të riklasifikohen (ose riciklohen) në pasqyrën e fitimit ose humbjes në një moment kohor në të ardhmen (për shembull pas mos-njohjes ose likuidimit) do të paraqiten veçmas nga zërat të cilët nuk do të riklasifikohen asnjëherë. Banka është në proces të vlerësimit të ndikimit të këtij amendimi në paraqitjen e pasqyrave të saj financiare.
- **SNK 12 Tatimi mbi fitimin (Rishikuar) – Rikuperimi i aktiveve të lidhura.**
Amendimi hyn në fuqi për periudhat vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2012. Amendimi sqaron përcaktimin e tatimit të shtyrë për aktivet afatgjata të investimit që maten me vlerën e drejtë. Amendimi prezanton një supozim të kundërshtueshëm, së tatimi i shtyrë për aktivet afatgjata të investimit, i cili matet sipas modelit të vlerës së drejtë në SNK 40, duhet të përcaktohet duke u bazuar në faktin se vlera kontabël neto e tij do të rikuperohet me anë të shitjes. Gjithashtu, ky amendim paraqet kërkesën që tatimi i shtyrë për aktivet që nuk zhvlerësohen të cilat maten nëpërmjet përdorimit të modelit të rivlerësimit në SNK 16, të matet gjithmonë në bazë të shitjes së aktivitetit. Banka është duke vlerësuar ndikimin e këtij amendimi tek gjendja financiare ose ecuria e bankës.
- **SNK 19 Përfitimet e punonjësve (Rishikuar).**
Amendimi hyn në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. BSNK ka nxjerrë disa amendime të SNK 19. Këto variojnë nga ndryshimet thelbësore si heqja e mekanizmit të intervalit dhe konceptit të kthimeve të pritshme nga aktivet deri në sqarime të thjeshta dhe riformulime. Zbatimi i hershëm i këtij standardi lejohet. Banka do të vlerësojë ndikimin dhe impaktin e këtij amendimi në pozicionin financiar ose ecurinë e Bankës.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.3 NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPJEGIMET (VAZHDIM)

(ii) Standarde të publikuara po akoma jo në fuqi (vazhdim)

- **SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (Rishikuar)**
Standardi hyn në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. Si rezultat i standardeve të reja SNRF 10 dhe SNRF 12, ajo që mbetet nga SNK 27 kufizohet në kontabilitetin për filialet, për njësitë e kontrolluara bashkërisht dhe pjesëmarrjet, në pasqyrat financiare individuale. Lejohet zbatimimi i hershëm i këtij standardi. Banka do të vlerësojë ndikimin dhe impaktin e këtij amendimi në pozicionin financiar ose ecurinë e bankës; megjithatë SNK 27 nuk është për momentin relevante për operacionet e Bankës.
- **SNK 28 Investime në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Rishikuar)**
Standardi hyn në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. Si rezultat i standardeve të reja SNRF 11 dhe SNRF 12, SNK 28 është riemërtuar SNK 28 Investime në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta, dhe përshkruan zbatimin e metodës së kapitalit për investime në sipërmarrje të përbashkëta krahas pjesëmarrjeve. Lejohet zbatimimi i hershëm i këtij standardi. Banka do të vlerësojë ndikimin e këtij amendimi në pozicionin financiar ose ecurinë e bankës; megjithatë SNK 28 nuk është për momentin relevant për operacionet e Bankës.
- **SNK 32 Instrumentat financiarë: Paraqitja (Rishikuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare.**
Amendimi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në dhe pas datës 1 Janar 2014. Ky amendim sqaron kuptimin “aktualisht ka të drejtë të detyrueshme për kompensim” dhe gjithashtu sqaron zbatimin e kriterëve të kompensimit për sistemet e likuidimit sipas SNK 32 (si sistemet qendrore të klerimit) të cilët zbatojnë mekanizma bruto likuidimi që nuk janë të njëkohshme. Amendimet e SNK 32 duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive. Zbatimimi i hershëm i këtij standardi lejohet. Megjithatë, nëse një njësi vendos ta aplikojë më herët, ajo duhet të prezantojë këtë fakt si dhe të paraqesë të dhënat sikurse kërkohen në zbatim të SNRF 7 Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare. Banka do të vlerësojë ndikimin e këtij amendimi në pozicionin financiar ose në ecurinë e Bankës.
- **SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve (Rishikuar) – Kërkesat e përmirësuara për dhënien e informacioneve shpjeguese për mos-njohjen (çregjistrimin).**
Amendimi hyn në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2011. Amendimi kërkon paraqitjen e të dhënave të tjera për mjetet financiare të cilat janë transferuar por nuk janë njohur për të mundur që përdoruesi i pasqyrave financiare të kuptojë marrëdhënien me këto mjete të cilat nuk janë çregjistruar dhe detyrimet e lidhura me to. Gjithashtu, amendimi kërkon paraqitjen e informacioneve shpjeguese për përfshirjen e vazhdueshme në aktivet që çregjistrohen për të bërë të mundur që përdoruesi i pasqyrave financiare të vlerësojë natyrën, rreziqet që lidhen me përfshirjen e vazhdueshme të subjektit në këto aktive që nuk njihen (çregjistrohen). Amendimi ka efekt vetëm në kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese.
- **SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve (Rishikuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare.**
Amendimi hyn në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. Amendimi paraqet kërkesat për zbulimin e të dhënave. Zbulimi i këtyre të dhënave do t'i sigurojë përdoruesit informacionin e nevojshëm për vlerësimin e efektit ose efekteve të mundshme të marrëveshjeve të kompensimit në pozicionin financiar të subjektit. Amendimet e SNRF 7 do të zbatohen në mënyrë retrospektive. Banka do të vlerësojë ndikimin e këtij amendimi në pozicionin financiar ose në ecurinë e Bankës.
- **SNRF 9 Instrumentat Financiare: Klasifikimi dhe Matja.**
Standardi i ri hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2015. SNRF 9 paraqet fazën e parë të punës së BSNK për zëvendësimin e SNK 39 dhe aplikohet në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare sikurse përcaktohet në SNK 39. Faza e parë e SNRF 9 do të ketë një ndikim të rëndësishëm mbi (i) klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe (ii) një ndryshim në raportim për ato subjekte të cilat i kanë përcaktuar detyrimet financiare duke përdorur metodën e vlerës së drejtë. Në fazat e mëvonshme, BSNK do të adresojë zhvlerësimet dhe kontabilitetin e zërave të mbrojtur. Përfundimi i këtij projekti pritet në mes të vitit 2012. Aplikimi i hershëm i këtij standardi lejohet. Banka do të vlerësojë ndikimin e standardit të ri në pozicionin financiar ose ecurinë e Bankës.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.3 NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPJEGIMET (VAZHDIM)

(ii) Standarde të publikuara po akoma jo në fuqi (vazhdim)

■ SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara.

Standardi i ri hyn në fuqi për periudhat vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. SNRF 10 zëvendëson pjesën e SNK 27 Pasqyra Financiare të Konsoliduara dhe Individuale të cilat adresojnë kontabilitetin për pasqyrat financiare të konsoliduara. Gjithashtu, përfshin çështjet e ngritura në SIC-12 Konsolidimi – Njësi me qëllim të posaçëm. SNRF 10 përcakton një model të vetëm kontrolli i cili zbatohet për të gjitha njësitë, përfshi dhe njësitë me qëllim të posaçëm. Sipas ndryshimeve që paraqiten në SNRF 10, menaxhimit i kërkohet të ushtrojë gjykimin e duhur për të përcaktuar se cilat njësi kontrollohen dhe për këtë arsye duhet të konsolidohen nga kompania mëmë, në krahasim me kërkesat e parashikuara në SNK 27. Banka do të vlerësojë ndikimin e standardit të ri në pozicionin financiar ose ecurinë e Bankës; megjithatë SNRF 10 për momentin nuk është relevante për operacionet e Bankës.

■ SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta.

Standardi i ri hyn në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. SNRF 11 zëvendëson SNK 31 Interesi për Sipërmarrjet e Përbashkëta dhe SIC-13 Njësi të kontrolluara bashkërisht – Kontributet jo-monetare nga Sipërmarrjet. SNRF 11 heq opsionin e kontabilizimit për njësitë të cilat kontrollohen bashkërisht (JSE) duke përdorur konsolidimin proporcional. Përkundrazi, njësitë e kontrolluara bashkërisht të cilat plotësojnë përkufizimin e sipërmarrjes së përbashkët duhet të kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit. Banka do të vlerësojë ndikimin e standardit të ri në pozicionin financiar ose ecurinë e Bankës; megjithatë SNRF 11 për momentin nuk është relevante për operacionet e Bankës.

■ SNRF 12 Shënime shpjeguese për përfshirjen me subjekte të tjera.

Standardi i ri hyn në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. SNRF 12 përfshin të gjitha shënimet shpjeguese që më parë kanë qenë përfshirë në SNK 27 për pasqyrat financiare të konsoliduara si dhe të gjitha shënimet shpjeguese që më parë janë përfshirë në SNK 31 dhe SNK 28. Shënimet shpjeguese lidhen me interesat e njësisë në filialet, marrëveshjet e përbashkëta, pjesëmarrjet dhe njësitë e strukturuar. Gjithashtu, kërkohen edhe disa shënime shpjeguese të reja. Banka do të vlerësojë ndikimin e standardit të ri në pozicionin financiar ose ecurinë e Bankës; megjithatë SNRF 12 për momentin nuk është relevante për operacionet e bankës.

■ SNRF 13 Matja me vlerë të drejtë.

Standardi i ri hyn në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. SNRF 13 përcakton një burim të vetëm udhëzimi sipas SNRF për të gjitha matjet me vlerë të drejtë. SNRF 13 nuk ndryshon kur një njësi duhet të përdore vlerën e drejtë, por ofron udhëzime lidhur me mënyrën e matjes së vlerës së drejtë sipas SNRF kur vlera e drejtë është e kërkuar ose e lejuar. Ky standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive dhe lejohet zbatimi i hershëm i tij. Banka do të vlerësojë ndikimin e standardit të ri në pozicionin financiar ose ecurinë e Bankës.

(iii) Përmirësime në SNRF (publikuar në Maj 2010)

Në Maj 2010, BSNK nxori përmblendjen e tretë të ndryshimeve të standardeve, kryesisht me qëllim heqjen e papajtueshmërive dhe sqarimin e formulimit. Ekzistojnë dispozita të veçanta të përkohshme për secilin standard. Ndryshimet renditen më poshtë:

- SNRF 3 Kombinimet e Bizneseve
- SNRF 7 Instrumentet Financiare — Shënime Shpjeguese
- SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare
- SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale
- SNK 34 Raportimi i Përkohshëm Financiar
- KIRFN 13 Programet për Besnikërinë e Klientit

Megjithatë Banka nuk parashikon që adoptimi i këtyre ndryshimeve të ketë ndikim në pozicionin financiar apo performancën e saj.

2.4 PËRMbledhje e politikave të RËNDËSISHME KONTABËL

(1) Transaksionet në monedhë të huaj

Gjatë hartimit të pasqyrave financiare, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e Bankës, janë njohur duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivekëtohen në Lek me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit. Aktivet jo monetare dhe detyrimet maten në kosto historike të monedhave të huaja dhe këmben me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(2) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kurset e këmbimit të aplikueshme (Lek ndaj një njësie të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2011 dhe 31 Dhjetor 2010 janë si më poshtë:

	31 /12/ 2011	31 /12/ 2010
USD	107.54	104.00
EUR	138.93	138.77
GBP	165.92	161.46
CHF	114.46	110.98
CAD	105.36	104.29
XAU	5,434.54	4,715.77

(2) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese

(i) Data e njohjes

Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur banka bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

(ii) Matja fillestare e instrumentave financiarë

Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emtuara dhe detyrimet e varura në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur banka angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

(iii) Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivët financiarë klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuara:

- Mjetet monetare dhe ekuivalente
- Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat
- Investimet e letrave me vlerë

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

(iv) Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emtuar nga Banka janë klasifikuar ose si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e Bankës pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emtuara nga Banka janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(2) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja (vazhdim)

(v) *Hua dhe paradhënie klientëve dhe bankave*

Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që Banka nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që banka ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që banka gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që banka, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Kur Banka është qiradhënës në një marrëveshje qiraje që transferon të qiramarrësit të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që lidhen me pronësisë e një aktivi, marrëveshja paraqitet brenda huave dhe paradhënies. Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një pasuri tërësisht e ngjashme) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("repo e anasjelltë ose huamarrje letrash me vlerë"), marrëveshja është kontabilizuar si marrëveshje e anasjelltë riblerjeje (letra me vlerë kolateralizuara) dhe aktivet e lidhura me to nuk njihen në pasqyrat financiare të Bankës. Pas matjes fillestare me vlerën e drejtë, shumat e huave dhe paradhënies për klientët dhe bankat janë matur më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

(vi) *Letrat me vlerë të investimit*

Letrat me vlerë të investimit kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre, ose si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

(1) Instrumenta financiarë të mbajtur deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat nuk janë dizenuar me vlerë të drejtë në fitim ose humbje ose të vlefshme për shitje.

Pas njohjes fillestare, investimet e mbajtura deri në maturim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Nëse banka do të shesë ose riklasifikojë para maturimit një shumë të rëndësishme të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim (përveçse në rrethana të caktuara specifike), e tërë kategoria do të "njolloset" dhe do të duhej të riklasifikohej si e vlefshme për shitje. Për më tepër, banka do ta kishte të ndaluar klasifikimin e ndonjë aktivi financiar si të mbajtur deri në maturim gjatë dy viteve në vijim.

(2) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative që nuk dizenuohen si një kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e kapitalit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbarten me kosto. Të gjitha investimet e vlefshme për shitje mbarten me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit në investimet e borxhit të vlefshme për shitje, njihen direkt në humbje ose fitim. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar të njihet në fitim ose humbje.

(vii) *Borxhi i emetuar dhe fonde të tjera të marra borxh*

Instrumentat financiarë të emetuar nga banka, që nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë klasifikuar si "borxhi i varur", ku substanca e marrëveshjes kontraktuale rezulton në atë që banka ka një detyrim për t'i shlyer mbajtësit, nëpërmjet mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare, ose të përmbushë detyrimin nëpërmjet një mënyre tjetër përveçse duke këmbyer një shumë të caktuar parash ose aktive të tjera financiare për një numër fiks aksionesh në kapitalin e vet.

Pas matjes fillestare, borxhi i emetuar dhe huamarrjet e tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Një analizë e borxhit të emetuar të bankës është paraqitur në Shënimin 21.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(3) Mosnjohja (çregjistrimi) e aktiveve dhe detyrimeve financiare

(i) Aktivet financiare

Banka nuk e njeh më një aktiv financiar (e çregjistron) nëse të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen te një njësi tjetër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilëve transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose një pjesë të rreziqeve ose shpërblimeve të aktiveve të transferuara. Në rast se Banka mbart të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve, ndërkohë që mbahen të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, përfshijnë për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi "swap" për aktivet e transferuara, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financues i sigurt i njëjtë me riblerjen e transaksionit.

Për transaksionet ku Banka as nuk mban dhe as nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh (çregjistron) aktivin në rast se nuk ka kontroll mbi të. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen gjatë transferimit njihen më vete si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Në ato transferime ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin për atë kohë sa ky aktiv rezultoi në përfshirë, gjë e cila përcaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në transaksione të caktuara Banka mban të drejtat e shërbimit ndaj një aktivi financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar çregjistrohet tërësisht nëse plotëson kriteret e mosnjohjes.

(ii) Detyrimet financiare

Banka çregjistron detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur, detyrimet e Bankës janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

(4) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, të mirinformuara që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Kur është e mundur, Banka e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksione të tregut aktual që kryhen në mënyrë të rregullt dhe në kushte të barabarta. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të mirinformuara të palidhura me njëra-tjetrën (nëse është e disponueshme), lidhur me vlerën e drejtë aktuale të instrumentave të tjerë që janë kryesisht të njëjtë, flukset monetare të skontuara dhe modelet e vlerësimit të opsioneve. Teknika e zgjedhur e vlerësimit bazohet maksimalisht te të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në llogaritjet specifike të Bankës, bashkon të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg konsiderojnë në vendosjen e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranura për vendosjen e çmimit për instrumentat financiare. Të dhënat për teknikat e vlerësimit paraqesin pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentat financiarë. Banka kalibron metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmëri duke përdorur çmime të vëzhguara në transaksionet aktuale të tregut në instrumenta të njëjtë ose në të dhëna të tjera të vëzhgueshme në treg.

Evidence më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e dhënë ose e marrë, vetëm nëse vlera e drejtë e atij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksione aktuale të tregut për instrumenta të njëjtë (p.sh., pa modifikime ose ripaketim) ose e bazuar në metodat e vlerësimit në të cilat variablat përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përfutur nga një model vlerësimi është njohur më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni të mbyllet.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(4) Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Aktivitet dhe pozicionimet afatgjata maten me çmimin e ofruar, detyrimet dhe pozicionimet afatshkurtra maten me çmimin e kërkuar. Kur Banka ka një pozicionim me rreziqe që kompensojnë njëri tjetrin, çmime "mid-market" janë përdorur për të matur pozicionin e rreziqeve të kompensuar dhe një çmim i kërkuar ose ofertë rregullimi është aplikuar vetëm tek pozicionet e hapura neto. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin rregullime të cilat marrin parasysh rrezikun e kreditimit të Bankës dhe të palës tjetër kur është e përshtatshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë të përfuara nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Banka beson që një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do i merrte ato në konsideratë për vendosjen e çmimit të një transaksioni.

(5) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në çdo datë bilanci Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuar kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të pasasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk zhvlerësohen specifikisht vlerësohen kolektivisht për çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuara) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidencë objektive që aktivet financiare (duke përfshirë letrat me vlerë të kapitalit neto) të zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Banka me kusht që Banka nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

(i) Aktivet financiare me kosto të amortizuara

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuara maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizionit kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdon të njihet përmes rikthimit të zbritjes. Kur një ngjarje e mëvonshme bën që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, humbja nga zhvlerësimi kthehet (njihet) nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje

Për instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje, banka vlerëson në çdo datë të pasqyrave financiare nëse ka evidencë objektive që një investim është zhvlerësuar.

Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje njihen duke transferuar përmes një riklasifikimi, humbjen kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, në fitim ose humbje. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera, në fitim ose humbje, është diferenca midis koston së blerjes, neto nga çdo shlyerje principali dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provizionet për zhvlerësim që i atribuohen vlerës në kohë janë pasqyruar si një komponent i të ardhurave nga interesi.

Nëse në një periudhë të mëvonshme vlera e drejtë e një letrë me vlerë të vlefshme për shitje që është zhvlerësuar rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrret), dhe shuma e kthimit njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, çdo rritje e mëvonshme në vlerën e drejtë të një letrë me vlerë të zhvlerësuar të kapitalit njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(5) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

(iii) Kreditë e rinegociuara

Kur është e mundur, banka kërkon të ristrukturojë kreditë në vend që të marrë në zotërim kolaterale. Kjo mund të përfshijë shtrirjen e afatit të pagesave dhe rënien dakord për kushte të reja të kredisë. Pasi kushtet janë rinegociuar, ndonjë zhvlerësim i mundshëm matet duke përdorur normën fillestare efektive të interesit, të llogaritur para modifikimit të termave dhe kredia nuk konsiderohet më me vonesë. Drejtimi vazhdimisht rishikon kreditë e rinegociuara për t'u siguruar që të gjitha kriteret janë përmbushur dhe se pagesat e ardhshme ka të ngjarë të ndodhin. Kreditë vazhdojnë të jenë subjekt i një vlerësimi individual apo kolektiv nga zhvlerësimi, i llogaritur duke përdorur normën fillestare efektive të interesit të kredisë.

(6) Kompensimi i instrumentave financiarë

Banka fshin kredi të caktuara kur ato përcaktohen si të pa-arketueshme. Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Bankës.

(7) Matja me kosto të amortizuar e instrumentave financiarë

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(8) Qiratë ("leasing")

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Banka si një qiramarrës

Qiratë që nuk transferojnë te banka në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale. Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë ("leasing"). Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Banka si një qiradhënëse

Qiratë ku banka transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e gjendjes financiare, Banka paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të paftuara. Të ardhurat nga shitja të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënëse në fillim të afatit të leasing-ut janë vlera e drejtë e aktivitetit, ose, nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut.

(9) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat njihen në atë masë që është e mundur që përfitimet ekonomike do të rrjedhin në bankë dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret e mëposhtme specifike të njohjes gjithashtu duhet të plotësohen para se të ardhurat njihen.

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë përdorimi të një mjeti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të paraqitura si fitim ose humbje përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(9) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve (vazhdim)

(ii) Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione dhe tarifa

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifën dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komisioni shitje, tarifën e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet. Shpenzime të tjera për tarifën dhe komisionet që lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që ofrohen shërbimet.

(10) Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

(11) Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimeve fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe më pas mbarten në varësi të klasifikimit të tyre, si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

(12) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitetit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitetit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimit në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes, kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që ne të ardhmen Banka do të ketë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivitetit përveçse për aktivitet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivitet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	% e amortizimit
Ndërtesa	5%
Pajisje elektronike	20%
Automjete	20%
Mobilie dhe pajisje zyre	20%
Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	5%

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(13) Aktivet jomateriale

(i) Programe kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në fitim ose humbje me normën 25% mbi vlerën e mbetur prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

(ii) Licencat

Licencat dhe të drejtat e përdorimit blerë nga Banka janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi nëse ka. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm atëherë kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare mbi jetën e dobishme të licencës që nga data që është e vlefshme për përdorim.

(14) Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të bankës, përveç aktiveve për tatime të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivit e tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivit ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(15) Garancitë Financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

(16) Përfitimet e punonjësve

(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Banka njihet si detyrim shumë të përlogaritur të koston që pritët të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

(iii) Sigurimet shëndetësore të punonjësve

Banka gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në bankë nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e paguara janë të regjistruar si detyrime.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(17) Provizione për detyrime të kushtëzuara dhe angazhime

Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare të ardhshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet specifike që lidhen me detyrimin.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet operative të ardhshme nuk janë provizionuar.

Një provizion për kontratat e dyshimta njihet kur përfitimet që priten të rrjedhin te Banka nga një kontratë janë më të ulëta se sa kostoja e pashmangshme e përmbytjes së detyrimeve sipas kontratës. Provizionin matet me më të ultën mes vlerës aktuale të koston së pritshme nga ndërprerja e kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimin me kontratën. Para se të njihet provizioni, Banka njeh çdo humbje nga zhvlerësimi mbi aktivet e lidhura me atë kontratë.

(18) Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

(i) Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në Pasqyrën e të Ardhurave Përmbledhëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk tatohen apo njihen si të zbritshëm asnjëherë.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohej nga ligji Shqiptar.

(ii) Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivët tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivit të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivët e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat priten të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhojat tatimore që do të vijojnë nga mënyra në të cilën Banka pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

(iii) Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, ose direkt në kapital, rast në të cilin tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen edhe në të ardhurat e tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, përkatësisht.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(20) Aktive afatgjata materiale te investuara

Aktivët afatgjata të investuara janë prona të mbajtura për të gjeneruar të ardhura nga qiraja dhe/ose për të gjeneruar të ardhura nga rivlerësimi i kapitalit, por jo për t'u shitur në aktivitetin normal të biznesit, për t'u përdorur në ofrimin e shërbimeve ose për qëllime administrative. Banka ka disa aktive afatgjata të investuara të cilat i ka marrë nga ekzekutimi i kolateraleve të huave dhe paradhënieve ndaj klientëve. Aktivët afatgjata të investuara maten me kosto në njohjen fillestare, duke përfshirë edhe kostot e transaksionit. Më pas ato maten me vlerën e drejtë. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga çdo ndryshim në vlerën e drejtë njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën lindin. Një aktiv material i investuar çregjistrohet kur prona për investim nxirret jashtë përdorimit dhe nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga ky pakësim (nxjerrje jashtë përdorimit). Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja e pronës (llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të aktivit) përfshihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën prona është çregjistruar.

(21) Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur janë burimet kryesore të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një "marrëveshje riblerjeje" për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Banka zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe i alokimit të shpenzimit të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skanton deri në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare, pagesat monetare të ardhshme të vlerësuar (përfshirë të gjitha taksat dhe shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (sipas rastit) përgjatë një periudhe më të shkurtër.

(22) Dividendët

Dividendët e aksioneve të zakonshme janë njohur si një detyrim dhe janë zbritur nga kapitali në momentin kur ata janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë miratuar pas datës së bilancit janë paraqitur si një ngjarje pas datës së bilancit.

(23) Rezervat e kapitalit

Rezervat e regjistruara në kapital (të ardhurat e tjera përmbledhëse) në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë:

"Rezervën e përgjithshme" që përfshin ndryshimet e bëra për rezervën ligjore siç përcaktohet në Ligjin e Bankës Qendrore dhe Ligjin Tregtar të zbatueshëm në Shqipëri.

"Rezerva e rivlerësimit" e cila është përdorur për të regjistruar ndryshimet e këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi i letrave me vlerë të investimit.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA INTERESAT

	Viti i mbyllur më 31/12/2011	Viti i mbyllur më 31/12/2010
Të ardhurat nga interesat		
Hua dhe paradhënie për klientët	6,101,149	4,424,571
Investime në instrumenta financiarë	575,732	449,694
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	83,292	48,802
Hua dhënë bankave	57,146	112,393
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	<u>121,197</u>	<u>94,762</u>
<i>Totali i të ardhurave nga interesat</i>	<i>6,938,516</i>	<i>5,130,222</i>
Shpenzimet për interesa		
Detyrime ndaj klientëve	(2,644,313)	(2,255,203)
Borxhi i varur	(93,539)	(90,325)
Detyrime ndaj bankave	(117,019)	(89,602)
Amortizimi i primit të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim	<u>(8,171)</u>	-
<i>Totali i shpenzimeve për interesa</i>	<i>(2,863,042)</i>	<i>(2,435,130)</i>
Të ardhurat neto nga interesat	<u>4,075,474</u>	<u>2,695,092</u>

4. TË ARDHURA DHE SHPENZIME NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	Viti i mbyllur më 31/12/2011	Viti i mbyllur më 31/12/2010
Të ardhura nga tarifatat dhe komisionet		
Komisione nga shërbimet bankare	355,236	296,378
Tarifa dhe komisione nga shërbimet e huadhënies	<u>34,863</u>	<u>19,504</u>
<i>Totali i të ardhurave nga tarifatat dhe komisionet</i>	<i>388,099</i>	<i>315,882</i>
Shpenzime për tarifa dhe komisione		
Veprime me thesarin	(33,419)	(35,288)
Tarifa për veprime ndërbankare	(50,057)	(14,903)
Të tjera	<u>(478)</u>	<u>(227)</u>
<i>Totali i shpenzimeve për tarifa dhe komisione</i>	<i>(83,954)</i>	<i>(50,418)</i>
Të ardhura neto nga tarifatat dhe komisionet	<u>304,145</u>	<u>265,464</u>

5. SHPENZIME PERSONELI

	Viti i mbyllur më 31/12/2011	Viti i mbyllur më 31/12/2010
Pagat e punonjësve	507,203	428,290
Sigurime shoqërore	60,019	50,634
Bonus dhe shpërblime	66,680	40,884
Sigurimet Shëndetësore	8,300	8,300
Të tjera	<u>11,840</u>	<u>9,763</u>
	<u>654,042</u>	<u>546,171</u>

6. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

	Viti i mbyllur më 31/12/2011	Viti i mbyllur më 31/12/2010
Qira	209,336	191,062
Sigurime dhe mbikëqyrje	242,763	184,887
Marketing dhe abonime	153,993	117,672
Mirëmbajtje	50,713	46,347
Ujë, energji	50,688	49,294
Tarifa për palë të treta	55,473	58,243
Gjopa për tatimin (shiko shënimin 23 dhe 28)	18,829	10,214
Transport dhe udhëtime	26,147	20,699
Pajisje	27,495	6,096
Të tjera	<u>28,560</u>	<u>46,658</u>
	<u>863,997</u>	<u>731,172</u>

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

7. SHPENZIMET E TATIMEVE MBI TË ARDHURAT

	Viti i mbyllur më 31/12/2011	Viti i mbyllur më 31/12/2010
Tatimi aktual	157,630	52,095
Shpenzime për tatimin e shtyrë /(përfitim)	35,027	27,491
Anulime të diferencave të përkohshme	(22,516)	-
Tatimi mbi fitimin	170,142	79,586

Fondet për zhvlerësimet regjistruar si shpenzim nga banka në përputhje me SNRF do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme për efekt tatimi, me kusht që ato të jenë certifikuar nga një auditues i jashtëm dhe të mos tejkalojnë limitet e përcaktuara nga Banka Qendrore. Në përputhje me legjislacionin tatimor në Shqipëri, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për 2011 dhe 2010 është 10%.

Anulimet (kthimet) e diferencave të përkohshme paraqesin gjendjen e akumuluar të detyrimeve të shtyra tatimore, të njohura më 31 Dhjetor 2010, për diferencat e përkohshme, të cilat janë kthyer dhe janë njohur në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të 2011, për shkak të ndryshimit në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat. Sipas ndryshimeve në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat, diferencat bëhen të përhershme dhe detyrimi i shtyrë tatimor në fund të vitit do të jetë zero.

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin është përmbledhur si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31/12/2011	Viti i mbyllur më 31/12/2010
Fitimi para tatimit	1,826,369	746,991
Tatim fitim i llogaritur si 10% e fitimit kontabël	182,637	74,699
Anulimi i diferencave të përkohshme	(22,516)	-
Shpenzime të pazbritshme	10,021	4,887
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	170,142	79,586

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit tek Autoritet Tatimore por fitimet ose humbjet e deklaruar për qëllime fiskale konsiderohen provizore derisa deklaratat tatimore dhe llogaritjet e tatimit të inspektohen autoritetet tatimore dhe një vlerësim final të lëshohet. Legjislacioni shqiptar mbi tatimin është subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore.

8. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE ME TO

	31/12/2011	31/12/2010
Aktive monetare në arkë	4,132,059	3,653,679
Llogarite rrjedhëse të pakushtëzuara me Bankën Qendrore	16,602	419,667
Llogarite rrjedhëse me bankat	1,471,842	1,119,736
Marrëveshje riblerjeje (Repo)	-	511,656
Vendosjet në tregun e parasë	4,569,541	9,653,757
	10,190,044	15,358,495

9. SHUMA TË KUSHTËZUARA ME BANKËN QENDRORE

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore lidhur me depozitën rezervë, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve pranë Bankës Qendrore si llogari rezervë. Rezerva ligjore nuk është e disponueshme për veprimtaritë e përditshme të Bankës.

Maturiteti i rezervës ligjore krijohet çdo muaj dhe norma e interesit të aplikuar te rezerva e konvertuar në Lek është 70% i normës së repo-s një-javore (norma bazë) në Shqipëri, e cila më 31 Dhjetor 2011 ishte 5%. Rezerva e vendosur në monedha të tjera nuk gjeneron interes.

10. HUA DHE PARADHËNIE BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE FINANCIARE

	31/12/2011	31/12/2010
Bankat dhe institucionet e tjera financiare rezidente	478,037	229,761
Bankat dhe institucione e tjera financiare jo-rezidente	618,589	447,107
Totali	1,096,626	676,868

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

11. HUA DHE PARADHËNIE KLIENTËVE

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve përbëhen si më poshtë:

	31/12/2011	31/12/2010
Hua dhe paradhënie për klientët me kosto të amortizuar	62,388,875	42,479,386
Fondi për humbje nga zhvlerësimi i huave	<u>(3,757,179)</u>	<u>(2,221,245)</u>
	58,631,696	40,258,141

Ndarja e huave dhe paradhënieve dhënë klientëve sipas sektorit, mund të detajohet si më poshtë:

	31/12/2011	31/12/2010
Hua për korporatat	38,945,433	25,049,778
Hua për individë	3,653,432	2,755,397
Hua me hipotekë	18,325,717	14,186,030
Qira financiare	749,696	479,189
Hua të tjera të mbuluara	<u>714,597</u>	<u>8,992</u>
	62,388,875	42,479,386
Fondi për humbje nga zhvlerësimi i huave	<u>(3,757,179)</u>	<u>(2,221,245)</u>
	58,631,696	40,258,141

Lëvizjet në fondin për humbje nga huatë mund të detajohen si më poshtë:

31 Dhjetor 2011 (në '000 LEK)	Hua për korporatat	Hua per individët	Hua hipotekare	Qira financiare	Huadhënie te tjera te mbuluara	Total
Gjendja në fillim të vitit 2010	771.856	180.030	245.949	15.408	174	1.213.417
Humbje nga zhvlerësimi i huave	846.026	147.900	328.508	270	-	1.322.704
Rimarrje	-	-	-	-	-	-
Fshirje kredish	(200.793)	(40.715)	(71.323)	(1.947)	(100)	(314.878)
Efekti i kurseve të këmbimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja në 31 Dhjetor 2010	1.417.089	287.215	503.134	13.731	74	2.221.243
Humbje nga zhvlerësimi i huave	978.201	108.024	624.407	123.504	16.344	1.850.480
Rimarrje	(10.382)	(173.886)	(75.624)	(9.215)	(1.104)	(270.211)
Fshirje kredish	(44.137)	(2.217)	(1.309)	-	-	(47.663)
Efekti i kurseve të këmbimit	<u>2.076</u>	<u>194</u>	<u>932</u>	<u>114</u>	<u>14</u>	3.330
Gjendja në 31 Dhjetor 2011	2.342.847	219.330	1.051.540	128.134	15.328	3.757.179
Më 31 Dhjetor 2010						
Zhvlerësimet individuale	819.970	175.566	230.339	-	-	1.225.875
Zhvlerësimet në grup	<u>597.119</u>	<u>111.649</u>	<u>272.796</u>	<u>13.732</u>	<u>74</u>	995.370
	1.417.089	287.215	503.135	13.732	74	2.221.245
Më 31 Dhjetor 2011						
Zhvlerësimet individuale	1.315.406	-	494.612	-	-	1.810.018
Zhvlerësimet në grup	<u>1.027.441</u>	<u>219.330</u>	<u>556.927</u>	<u>128.135</u>	<u>15.328</u>	1.947.161
	2.342.847	219.330	1.051.539	128.135	15.328	3.757.179

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

12. LETRA ME VLERË TË INVESTUARA

Letrat me vlerë të investuara të vlefshme për shitje dhe të mbajtura deri në maturim janë të përbërë si më poshtë:

12.1 LETRAT ME VLERË TË INVESTUARA TË VLEFSHME PËR SHITJE

	Viti i mbyllur më 31/12/2011	Viti i mbyllur më 31/12/2010
<i>Të vlefshme për shitje</i>		
Bono thesari	2,263,217	4,723,805
Obligacione qeveritare	1,846,050	3,138,357
	4,109,267	7,862,162

Bono thesari

Normat efektive të interesit të bonove të thesarit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011 variojnë midis 5.71% dhe 6.42% p.a. (2010: 5.27% dhe 8.95% në vit.). Detaje të bonove të thesarit sipas llojit janë paraqitur më poshtë:

	31 /12/ 2011					
	Vlera nominale	Zbritja e shtyrë	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël	Diferenca e rivlerësimit	Vlera e drejtë
3 muaj	-	-	-	-	-	-
6 muaj	693,153	(22,007)	10,650	681,797	1,370	683,167
12 muaj	1,630,611	(112,533)	54,372	1,572,450	7,600	1,580,050
	2,323,764	(134,540)	65,022	2,254,247	8,970	2,263,217

	31 /12/ 2010					
	Vlera nominale	Zbritja e shtyrë	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël	Diferenca e rivlerësimit	Vlera e drejtë
3 muaj	55,230	(716)	16	54,530	5	54,535
6 muaj	782,130	(25,646)	10,533	767,017	1,771	768,788
12 muaj	4,050,547	(296,199)	125,645	3,879,993	20,489	3,900,482
	4,887,907	(322,561)	136,194	4,701,540	22,265	4,723,805

Obligacione qeveritar

	31 /12/ 2011					
	Vlera nominale	Zbritja e shtyrë	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël	Diferenca e rivlerësimit	Vlera e drejtë
24 muaj	550,000	-	12,943	562,943	1,593	564,537
36 muaj	-	-	-	-	-	-
60 muaj	1,247,561	-	30,868	1,278,429	3,085	1,281,514
	1,797,561	-	43,811	1,841,372	4,678	1,846,051

	31 /12/ 2010					
	Vlera nominale	Zbritja e shtyrë	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël	Diferenca e rivlerësimit	Vlera e drejtë
24 muaj	1,524,538	-	28,669	1,553,207	16,752	1,569,959
36 muaj	50,000	-	-	50,000	3,098	53,098
60 muaj	1,430,737	-	40,398	1,471,135	44,164	1,515,300
	3,005,275	-	69,067	3,074,342	64,014	3,138,357

12.2 LETRA ME VLERË TË INVESTUARA TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

	Viti i mbyllur më 31/12/2011	Viti i mbyllur më 31/12/2010
<i>Të mbajtura deri në maturim</i>		
Bono thesari	834,274	-
Obligacione qeveritare	1,319,626	-
	2,153,900	-

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

12. LETRA ME VLERË TË INVESTUARA (VAZHDIM)

12.2 LETRA ME VLERË TË INVESTUARA TË MBAJTURA DERI NE MATURIM (VAZHDIM)

Bono Thesari:

Norma efektive e interesit për bonot e thesarit të mbajtura deri në maturim në 31 Dhjetor 2011 ishte 5.66%.

					31/12/ 2011	
	Vlera nominale	Zbritja e shtyrë	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël	Diferenca e panjohur e rivlerësimit	Vlera e drejtë
3 muaj	-	-	-	-	-	-
6 muaj	-	-	-	-	-	-
12 muaj	865,248	(60,362)	29,388	834,274	4,524	838,798
	865,248	(60,362)	29,388	834,274	4,524	838,798

Obligacionet qeveritare:

Më 31 Dhjetor 2011, Banka ka një portofol me obligacione qeveritare 2 vjeçare, 3 vjeçare, dhe 5 vjeçare, në monedhë vendase (Lek). Interesi (kupon) arkëtohet çdo 6 muaj dhe është respektivisht 8.44 % (2-vjeçare), 8.45 % (3-vjeçare), 9.22 % (5-vjeçare).

						31 /12/ 2011
	Vlera nominale	(Zbritja)/ Primi i shtyrë	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël	Diferenca e panjohur e rivlerësimit	Vlera e drejtë
24 muaj	946,347	3,926	18,727	969,000	(5,587)	963,413
36 muaj	250,000	825	10,011	260,836	1,666	262,502
60 muaj	83,176	3,826	2,787	89,790	(5,477)	84,313
	1,279,523	8,578	31,525	1,319,626	(9,398)	1,310,228

Tabela më poshtë tregon lëvizjet në gjendjet e investimeve të mbajtura deri në maturim dhe të vlefshme për shitje më 31 Dhjetor 2011 dhe 31 Dhjetor 2010, përfshirë këtu shtesat, maturimet dhe shitjet e investimeve gjatë këtyre viteve:

	Lëvizjet në të vlefshmet për shitje		Lëvizjet në të mbajturat deri në maturim	
	31/12/2011	31/12/2010	31/12/2011	31/12/2010
Gjendja më 1 Janar	7.862.162	3.403.165	-	-
Riklasifikime	(3.703.055)	-	3.703.055	-
Shtesa	2.615.568	7.231.028	1.190.503	-
Maturime	(2.592.776)	(2.858.311)	(2.739.658)	-
Luhatje në vlerën e drejtë	(72.632)	86.280	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor	<u>4.109.267</u>	<u>7.862.162</u>	<u>2.153.900</u>	-

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

13. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Ndërtesa	Pajisje elektronike dhe zyre	Automjete, mobilie dhe pajisje të tjera	Investime në ambiente me qira	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 Janar 2010	286,839	571,543	130,391	212,114	1,200,887
Shtesat	-	105,509	10,374	39,185	155,068
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	(779)	(345)	-	(1,123)
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	<u>286,839</u>	<u>676,273</u>	<u>140,420</u>	<u>251,299</u>	<u>1,354,831</u>
Shtesat	-	51,546	48,192	9,704	109,442
Transferimet	-	(11)	417	(406)	-
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	(14,771)	(10,620)	-	(25,391)
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	<u>286,839</u>	<u>713,037</u>	<u>178,409</u>	<u>260,597</u>	<u>1,438,882</u>
Amortizimi					
Gjendja më 1 Janar 2010	(66,573)	(258,379)	(50,088)	(65,336)	(440,375)
Amortizimi i periudhës	(14,342)	(75,713)	(15,763)	(22,651)	(128,469)
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	478	23	-	501
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	<u>(80,915)</u>	<u>(333,614)</u>	<u>(65,828)</u>	<u>(87,987)</u>	<u>(568,344)</u>
Amortizimi i periudhës	(14,342)	(78,433)	(16,445)	(24,374)	(133,594)
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	8,987	6,240	-	15,227
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	<u>(95,257)</u>	<u>(403,060)</u>	<u>(76,033)</u>	<u>(112,361)</u>	<u>(686,711)</u>
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 1 Janar 2010	<u>220,266</u>	<u>313,164</u>	<u>80,303</u>	<u>146,779</u>	<u>760,511</u>
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	<u>205,924</u>	<u>342,659</u>	<u>74,591</u>	<u>163,312</u>	<u>786,486</u>
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	<u>191,582</u>	<u>309,979</u>	<u>102,374</u>	<u>148,236</u>	<u>752,171</u>

14. AKTIVE JO-MATERIALE

	Programe kompjuterike	Patenta dhe Licenca	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 Janar 2010	71,447	19,651	91,098
Shtesat	7,209	-	7,209
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	(4,857)	(4,857)
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	<u>78,656</u>	<u>14,794</u>	<u>93,450</u>
Shtesat	25,412	3,070	28,482
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	<u>104,068</u>	<u>17,864</u>	<u>121,932</u>
Amortizimi			
Gjendja më 1 Janar 2010	(47,344)	(5,261)	(52,605)
Amortizimi i periudhës	(7,163)	(2,644)	(9,807)
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	<u>(54,507)</u>	<u>(7,905)</u>	<u>(62,412)</u>
Amortizimi i periudhës	(11,531)	(2,308)	(13,839)
Transferimet	(303)	303	-
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	<u>(66,341)</u>	<u>(9,910)</u>	<u>(76,251)</u>
Vlera e mbartur			
Gjendja më 1 Janar 2010	<u>24,103</u>	<u>14,390</u>	<u>38,493</u>
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	<u>24,149</u>	<u>6,889</u>	<u>31,038</u>
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	<u>37,727</u>	<u>7,954</u>	<u>45,681</u>

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

15. AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA

Aktivët dhe detyrimet tatimore të shtyra përbëhen si më poshtë:

	31 /12/ 2011			31 /12/ 2010		
	Aktivët	Detyrimet	Neto	Aktivët	Detyrimet	Neto
Kapitali aksionar	41,542	-	41,542	41,542	-	41,542
Interesi i pafitur mbi disbursimin e huasë	-	(44,969)	(44,969)	-	(9,942)	(9,942)
Fond për humbje nga zhvlerësimi i huave	-	-	-	-	(22,516)	(22,516)
Provizion për humbje nga Garancitë	84	-	84	84	-	84
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	-	(1,363)	(1,363)	-	(8,628)	(8,628)
Tatimi i shtyrë aktiv neto	41,626	(46,332)	(4,707)	41,626	(41,086)	540

Aktivi për tatimet e shtyra është regjistruar neto nga tatimi i shtyrë pasiv meqë shumat janë si rrjedhojë e të njëjtit autoritet tatimor dhe parashikohen të mbyllen. Më 31 Dhjetor 2011 të gjitha aktivët ose pasivët e mësipërme për tatimet e shtyra njihen në pasqyrat financiare. Siç është përmendur edhe më parë në shënimin 7, për shkak të rishikimeve të limituara në legjislacionin tatimor, ka pasiguri nëse tatimi i shtyrë do të realizohet në të ardhmen, megjithatë Drejtimi i Bankës beson se ka pak mundësi që nuk do të ketë përfitime në të ardhmen.

16. AKTIV AFATGJATË MATERIAL I INVESTUAR

Drejtimi i Bankës i klasifikon këto pasuri të marre nga ekzekutimi i kolateraleve të huave ndaj klientëve si aktive afatgjata materiale të investuara nga pasiguria për përdorimin e tyre dhe shitjen e mëvonshme. Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale të investueshme është vlera e drejtë e pasurisë përcaktuar nga vlerësues të regjistruar të pavarur.

	31 /12/ 2011	31 /12/ 2010
Gjendja më 1 Janar	186,493	77,520
Shtesa (shpenzime pasuese)	29,632	108,973
Nxjerrja jashtë përdorimi	(7,886)	-
Fitimi neto nga rregullimi i vlerës së drejtë	2,317	-
	210,556	186,493

Vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar llogaritet duke u bazuar mbi vlerën e tregut, që nënkupton çmimin me të cilin mallrat dhe shërbimet e ngjashme të së njëjtës cilësi dhe sasi do të mund të shiteshin në një transaksion tregtar të paanshëm. Më 31 Dhjetor 2011, aktivi afatgjatë material i investuar përfshin toka, ndërtesa dhe një makinë.

17. AKTIVE TË TJERA

	31 /12/ 2011	31 /12/ 2010
TVSH e kreditueshme	52,992	61,181
Debitorë	130,302	63,956
Shpenzime të parapaguara	24,741	34,658
	208,035	159,795

18. DETYRIMET NDAJ BANKAVE

Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare janë të detajuara si më poshtë:

	31 /12/ 2011	31 /12/ 2010
Llogari rrjedhëse:		
Rezident	399,731	169,410
Jo Rezident	310,769	507,120
Depozitat e tregut të pasasë:		
Rezident	1,373,380	1,170,883
Jo Rezident	322,620	-
	2,406,500	1,847,413

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

19. HUATË

Gjatë vitit 2009 Banka siguroi një hua nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me një shumë prej Lek 124,651 mijë me një interes vjetor prej 0.5%. Më 31 Dhjetor 2011 teprica e huave është Lek 125,447 mijë (2010: Lek 134,427 mijë).

20. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE

	31 /12/ 2011	31 /12/ 2010
Individë	56,805,410	45,245,814
Korporata	6,113,669	6,772,952
Ente Qeveritare	6,325,032	8,067,188
Klientë të tjerë	<u>2,151,045</u>	<u>2,079,660</u>
	<u>71,395,156</u>	<u>62,165,614</u>

Detyrimet ndaj klientëve sipas monedhave detajohen si më poshtë:

	31 /12/ 2011	31 /12/ 2010
Llogari rrjedhëse		
Në monedhë vendase	7,825,328	7,516,747
Në monedhë të huaj	3,201,222	4,796,068
Llogari kursimi		
Në monedhë vendase	940,401	574,177
Në monedhë të huaj	1,657,768	1,012,929
Depozita me afat		
Në monedhë vendase	29,059,900	22,815,808
Në monedhë të huaj	28,064,802	24,742,655
Llogari të tjera klienti		
Në monedhë vendase	107,284	143,382
Në monedhë të huaj	<u>538,451</u>	<u>563,848</u>
	<u>71,395,156</u>	<u>62,165,614</u>

21. DETYRIME TË VARURA

Detyrimet e varura detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
SECO	579,350	577,783
Fondi Evropian për Evropën Juglindore	851,757	850,776
Instrumente të varura	<u>785,583</u>	-
	<u>2,216,690</u>	<u>1,428,559</u>

Më 12 Dhjetor 2007 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve aprovoi marrjen e borxhit të varur prej Euro 2 milion nga State Secretariat for Economic Affairs (SECO) i cili operon nëpërmjet Swiss Investment Fund for Emerging Markets (SIFEM). Borxhi në Euro mbart interesin e Euribor + 3% në vit. Ky borxh do të ripaguhet me këste të barabarta prej Euro 666,666 më 31 Dhjetor 2013, 2014, 2015 ose Banka mund ta shlyejë atë para afatit të maturimit. Por pavarësisht skemës së mësipërme të shlyerjes nëse do të rezultojnë ndryshime në kontrollin e pronësisë së Bankës, ky borxh do të ripaguhet në mënyrë të menjëhershme SECO-s.

Me 8 shkurt 2008, Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve aprovoi marrjen e borxhit të varur prej EUR 2 milion nga European Fund for Southeast Europe (EFSE). Më 31 Korrik 2008, Banka mori një disbursim shtesë prej EUR 3 milion. Borxhi mbart një normë interesi fikse prej 7.85% në vit për 5 vjet nga dita e disbursimit dhe më pas rritet në 12.85% në vit. Çdo pagesë për borxhin duhet të ripaguhet në 10 vjet nga dita e disbursimit; ose Banka mund të ripaguajë huanë në çdo datë 22 mars ose 22 shtator pas 5 vjeçarit të parë nga data e disbursimit me një lajmërim 90 ditë më përpara.

Më 11 Nëntor 2008, Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve aprovoi marrjen e borxhit të varur prej EUR 2,120,000 nga SECO. Borxhi mbart një normë interesi Euribor +3% në vit.

